

RAPORTI VJETOR 2016

NE JU OFROJMË SHËRBIMIN ME CILËSINË MË TË LARTË



PJESË E
KASTRATI GROUP

Adresa

ALBSIG sh.a
Rruga "George W. Bush", Nr. 10,
Tirana, Albania



Telefon & Fax

Tel: +355 422 54 764
Cel: +355 68 20 52 744



Online

Email: info@albsig.al
Website: www.albsig.al

RAPORTI VJETOR 2016

NE JU OFROJMË SHËRBIMIN ME CILËSINË MË TË LARTË



PJESË E
KASTRATI GROUP

Adresa

ALBSIG sh.a
Rruga "George W. Bush", Nr. 10,
Tirana, Albania



Telefon & Fax

Tel: +355 422 54 764
Cel: +355 68 20 52 744



Online

Email: info@albsig.al
Website: www.albsig.al

PËRMBAJTJA.

1. Informacioni rreth shoqërisë

- 1.1 Misioni, vizioni dhe filozofia e shoqërisë
- 1.2 Profili i shoqërisë
- 1.3 Struktura qeverisëse

2. Treguesit kryesore të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2016

3. Veprimtaritë kryesore gjatë vitit 2016

- 3.1 Analiza vjetore e veprimtarisë së Albsig, 2016-ta, vit i rritjes intensive
- 3.2 Albsig on-line Faqja webit, një hap para të tjerëve
- 3.3 Brandi Albsig më i fort më i konkureshëm si pjesë e Kastrati Group
- 3.4 Albsig, më kualitativ dhe me synim kryesor rekrutimin e punonjësve sa më të kualifikuar.
- 3.5 Albsig rritet e zgjerohet me kontrata të reja siguruese
- 3.6 Albsig pjesë e panairëve, workshopeve dhe intershipeve sa më afër studenteve
- 3.7 Albsig në aktivitetet Social-Kulturore
- 3.8 Albsig gëzon e feston

4. Politikat e monitorimit, administrimit dhe kontrollit të rrezikut të shoqërisë

- 4.1 Menaxhimi i riskut, strategjia dhe politikat e menaxhimit të riskut
- 4.2 Strategjia e riskut
- 4.3 Parimet kryesore të menaxhimit të rrezikut
- 4.4 Oreksi i riskut dhe kufijtë e tolerancës së rrezikut të miratuara
- 4.5 Përbushja e Politikës së menaxhimit të riskut

5. Raporti i Audituesit të Pavarur

- Pasqyra individuale e pozicionit financiar
- Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse
- Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital
- Pasqyra individuale e flukseve monetare
- Shënimet shpjeguese të Pasqyrave financiare individuale
- Skedule suplementare

6. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm për vitin 2016

- Opinioni i Auditorit të Brendshëm

7. Objektivat e shoqërisë për vitin 2017

1. INFORMACIONI RRETH SHOQËRISË

Hyrje

Albsig sh.a. ("Shoqëria") është themeluar në vitin 2004 si një shoqëri sigurimi me vendndodhje në Shqipëri. Shoqëria është një shoqëri aksionare me kapital të përbashkët, e regjistruar sipas Ligjit Shqiptar nr.7638, datë 19 nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Nr. 28154, datë 9 janar 2004.

Albsig sh.a. ("Shoqëria") është themeluar në vitin 2004 si një shoqëri sigurimi me vendndodhje në Shqipëri. Shoqëria është një shoqëri aksionare me kapital të përbashkët, e regjistruar sipas Ligjit Shqiptar nr.7638, datë 19 nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Nr. 28154, datë 9 janar 2004. Shoqëria operon sipas një liçense të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare ("AMF"), më përpara i njohur si Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve ("AMS"), për tregtimin e policave të përgjithshme të sigurimit sipas rregullave të AMF-së në territorin e Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jo-jetës është marrë më datë 19 qershor 2004, ndërsa liçensa që specifikon klasat e aktiviteteve është lëshuar më datë 10 shtator 2004 nga AMS. Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë dhënien e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorike, pasurinë, shëndetin, dhe produkte të tjera të sigurimit jo-jetë. Shoqëria ka 19 degë në Tiranë, Durrës, Dibër, Sarandë, Pogradec, Shkodër, Fier, Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Kukës, Gjirokastrë, Berat, Permet, Erseke, Peshkopi, Lushnje and Burrel. Më 31 dhjetor 2015, shoqëria punësoi gjithsej 170 punonjës dhe drejtues (më 31 dhjetor 2014: 142). Gjatë vitit 2007 Shoqëria filloi aktivitetin në territorin e Republikës Maqedonë nëpërmjet Albsig A.D.Shkup ("Filiali"). Filiali është 100% i zotëruar nga shoqëria e sigurimit ALBSIG sh.a. Tiranë, Shqipëri ("Shoqëria mëmë"). Filiali është regjistruar më 23 prill 2007, është vendosur dhe funksionon në Republikën e Maqedonisë. Ai është liçensuar për të ofruar 11 klasa të sigurimit të jo-jetës; megjithatë aktivitetet kryesore të tij përfshijnë ofrimin e shërbimeve të sigurimit në fushat e mjeteve motorike, pasurisë dhe ndaj aksidenteve.



MESAZHI I
DREJTORIT TE
PERGJITHSHEM

MUHARREM BARDHOCI

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Kam kënaqësinë të ndaj me ju Raportin Vjetor të Vitit 2016, i cili pasqyron një përmbledhje të sfidave, zhvillimeve, rreziqeve dhe arritjeve të shoqërisë sonë përgjatë këtij viti. Gjithashtu përfitoj nga rasti të ndaj me ju vizionin dhe strategjinë për vitin 2017, ambiciet dhe pikat e mbështetjes së kësaj strategjie.

Veprimtaria ekonomiko-financiare e vitit 2016 për shoqërinë Albsig ka sjellë në konsolidimin e mëtejshëm të saj, duke përfaqësuar një subjekt të konsoliduar, konform të gjitha standarteve dhe kërkesave të akteve ligjore e nënligjore. Për shoqërinë tonë viti 2016 ka shënuar një rritje në 9.91% së saj në treg në fund të vitit 2015. Ky rezultat është rrjedhojë e një pune më të madhe në futjen e produkteve të reja të sigurimit vullnetar. Për produktet e detyrueshme motorike, prezenca në treg është rreth 10.09 %.

Ndër objektivat kryesorë të shoqërisë për vitin 2016 është rritja e prezencës në tregun e sigurimeve nëpërmjet shfrytëzimit më mirë të mundësive që ofron tregu, me synimin e arritjes së 15 % të potencialit të tij. Kjo do të mundësohet me ngritjen e nivelit profesional të specialistëve të marrjes së sigurimit, me eficienten e strukturave të reja tashme të krijuara si dhe në pershtatje me tendencat e tregut të sigurimeve për gjenerimin e produkteve të reja për të qenë sa më afër klientit dhe bizneseve.

Filozofia e shoqërisë sonë është t'u ofrojë mbrojtje dhe siguri të gjithë klientëve dhe bizneseve, në mbështetje të një rritje të qëndrueshme, si dhe në përmbytje të nevojave dhe pritshmerive të të gjithë aktorëve.

Albsig do të vazhdojë të ndërtojë një kulturë të punës, që të mendojë e veprojë në çdo moment se klienti është i pari.

Albsig, është dhe do të perpiqet të jetë një shoqëri me standarte shumë të mira në shërbim të të gjithë klientëve. Kjo është filozofia që do të shoqërojë Albsig edhe në të ardhmen.

UNË JU FALËNDEROJ TË GJITHËVE PËR MBËSHTETJEN TUAJ TË VAZHDUESHME.

1.1 MISIONI DHE VIZIONI



MISIONI

Për të zhvilluar Biznesin e Sigurimeve në interesin më të mirë të komunitetit.

Për të provuar sigurinë financiare të individëve, bizneseve, duke ofruar produkte sigurimi & shërbime të kualitetit të lartë me kosto të përballueshme.

VIZIONI

Për të qenë më të respektuar, më të besuar dhe me shërbim të standarteve më të mira në sigurimin e jo-jetës në tregjet ku operojmë.

FILOZOFIA

Me besimin konsumator, si një themel në të gjithë aktivitetin, Albsig përpiqet në mënyrë të vazhdueshme, për të rritur vlerat dhe për të qëndruar sa më kompetitiv në treg.



1.2 PROFILI I SHOQËRISË



Emri i shoqërisë:	Alb-Siguracion sh.a.
Lokalizimi i zyrave qendrore:	Adresa: Rr. "George W. Bush", No. 10 - Tirana, Albania Tel: +355 4 22 54 770 Tel: +355 4 22 54 764 Fax: +355 4 2254 664 www.albsig.al
Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës:	Z. Shefqet Kastrati Z. Bajram Xhaja Znj. Ilda Mucmataj
Drejtor i Përgjithshëm:	Z. Muharrem BARDHOCI
Data e themelimit:	09 / 01 / 2004
Kapitali:	879,460,000 lek
Numri i punonjësve:	141
Biznesi kryesor:	Non-life insurance



1.3 STRUKTURA QEVERISËSE

Organet më të larta të shoqërisë Albsig sh.a janë Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe Këshilli Mbikëqyrës.

Kompetencat e këtyre organeve drejtuese përcaktohen në Statutin e Shoqërisë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

Shoqëria Alb-Siguracion Sh.a ka këtë Strukturë Organike:

Asambleja e Përgjithshme e aksionareve
Këshilli mbikëqyrës

Komitetet

1. Komiteti i Administrimit të Rrezikut
2. Komiteti i Auditimit

Drejtori i Përgjithshëm

Zv/Drejtorët e Përgjithshëm

Departamentet

Departamenteti i Marrjes në Sigurim të Pronës dhe Risigurimit

- i. Sigurimi i Pronës
- ii. Sigurimi i shëndetit
- iii. Njësia e zhvillimit të produktit, inovacionit dhe marketingut
- iv. Risigurimi dhe Marrëdhëniet me jashtë

Departamenteti i Marrjes në Sigurim për Produktet Motorike dhe Administrimi i Rrjetit

- i. Sigurimi i detyrueshëm motorik (MTPL)
- ii. Marrëdhëniet me bankat & Leasing
- iii. Sigurimi Kasko, GPS
- iv. Degët

Departamenteti i Dëmeve

- i. Dëmet TPL
- ii. Dëmet e Kartonit Jeshil dhe Kasko
- iii. Dëmet e shëndetit
- iv. Njësia e investigimit
- v. Kontrolli i informacionit statistikor dhe rakordimi i dëmeve

Departamenteti i Financës dhe Kontabilitetit

- i. Njësia e Kontabilitetit
- ii. Njësia e Financës
- iii. Njësia e raportimit financiar

Departamenteti i Menaxhimit të Rriskut dhe IT

- i. Njësia e Aktuaristikës dhe Statistikës
- ii. Njësia e Teknologjisë së Informacionit
- iii. Njësia e Zbatueshmërisë/Përputhshmërisë

Departamenteti Juridik

- i. Njësia e Cështjeve Administrative & AML
- ii. Proceset Gjyqësore dhe Paditë e Regresit
- iii. Njësia e Pajtueshmërisë

Departamenteti i Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimet Administrative

- i. Burimet Njerëzore (HR)
- ii. Shërbimet Administrative, Protokoll & Arkivë
- iii. Sekretar/Recepsion

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Kjo strukturë e re organike është për një funksionim më të mirë dhe gjithpërfshirës të të gjithë Shoqërisë e cila paraqitet në organigramën në aneksin 1 (bashkëlidhur)

KAPITALI I NËNSHKRUAR

Kapitali i paguar i shoqërisë më 31 Dhjetor 2014 është 879,460 mijë Lekë.

Kapitali i paguar së bashku me Fitimin e mbartur me 31 Dhjetor 2016 është 1.076.126.648.

VEPRIMTARI SIGURIMI JO-JETË, NË KLASAT E SIGURIMIT MË POSHTË:

Liçenca i jep të drejtën Shoqërisë së Sigurimeve Albsig Sh.a e kryerjes së operacioneve të sigurimit në cilësinë e operatorit të Jo-Jetës sipas grupeve të sigurimit të listuara më poshtë:

- * Grupi nr. 1 "Aksidente"
- * Grupi nr. 2 "Sëmundjet"
- * Grupi nr. 3 "Mjete tokësore" (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)
- * Grupi nr. 4 "Mjete lëvizëse mbi shina"
- * Grupi nr. 5 "Avionët"
- * Grupi nr. 6 "Anijet"
- * Grupi nr. 7 "Mallrat në transport"
- * Grupi nr. 8 "Zjarri dhe forcat e natyrës"
- * Grupi nr. 9 "Dëmtime të tjera të pasurisë"
- * Grupi nr. 10 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i automjeteve"
- * Grupi nr. 11 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i avionëve"
- * Grupi nr. 12 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i anijeve"
- * Grupi nr. 13 "Përgjegjësitë civile të përgjithshme"
- * Grupi nr. 15 "Garancitë"

2. TREGUESIT KRYESORE TË AKTIVITETIT TË SHOQËRISË GJATË VITIT 2016

Përgjatë periudhës 01 Janar – 31 Dhjetor 2016:

Aktiviteti i shoqërisë për vitin 2016 vlerësohet pozitiv. Bilanci i shoqërisë rezulton me fitim. Veprimtaria ekonomiko-financiare e vitit 2016 çoi në konsolidimin e mëtejshëm të shoqërisë. Albsig Sh.a tashmë përfaqëson një subjekt të konsoliduar, konform të gjitha standarteve dhe kërkesave të akteve ligjore e nënligjore.

Aktiviteti ekonomik përgjatë vitit 2016 ka shënuar progress të ndjeshëm. Është rritur prezenca e Albsig sh.a në tregun e sigurimeve jo-jetë, nga 9.91% në fundvitin 2015 në 12.09% në fundvitin 2016 kjo rrjedhë nga një punë shumë rezultative në linjat e produkteve vullnetare. Për linjat e detyrueshme motorike, prezenca në treg është rreth 10.52 % në fund të vitit 2016 nga 10.09 % në fund të vitit 2015. Për produktet vullnetare prezenca në treg është rritur ndjeshëm. Për vitin 2016 është 15.16 % nga 9.59 % në vitin 2015. Për vitin 2016 ka një rritje me 68.61 % kundrejt vitit 2015 në primet vullnetare.

Për vitin 2016 rritja totale e tregut të sigurimeve jo - jetës është 10.25 %, ndërsa rritja e Albsig sh.a është 34.46%.

Primet e Shkruara Bruto nga Shoqëritë e Sigurimit të Jo-Jetës					
			Ndryshimi	Pjesa ndaj Totalit	
Shoqëria e sigurimit	Vlera (në mijë lekë)		(në %)	(në %)	
Viti	2015	2016	16/15-1	2015	2016
Primi i Shkruar Bruto					
Sigal Uniqa Group Austria	3,746,513	3,943,328	5.25	28.71	27.41
Eurosig	1,985,090	2,247,617	13.22	15.21	15.63
Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group	2,134,516	2,080,062	-2.55	16	14.46
Albsig	1,293,250	1,738,942	34.46	9.91	12.09
Intersig Vienna Insurance Group	1,570,769	1,600,945	1.92	12.04	11.13
Insig	762,194	959,599	25.90	5.84	6.67
Atlantik	800,240	938,587	17.29	6.13	6.53
Ansig	754,736	875,259	15.97	5.78	6.08
TOTAL	13,047,308	14,384,340	10.25	100.00	100.00

Tabela 1. Primet e Shkruara Bruto nga Shoqëritë e Sigurimit të Jo-Jetës

Tek sigurimet vullnetare rritja e Albsig Sh.a krahasimisht me vitin 2015 është 68.61 %, ndërsa në sigurimet e detyrueshme rritja e Albsig Sh.a krahasimisht me vitin 2015 është 16.96 %. Në total rritja krahasimisht me 2015 është 34.46%.

Në totalin e të ardhurave nga sigurimet kanë predominuar sigurimet e detyrueshme motorike (TPL,Kartoni Jeshil dhe Sigurimi Kufitar) që përbëjnë rreth 57.50% të të ardhurave nga primet, ndërsa produktet vullnetare 42.50 %.

Ndarja e Tregut në Sigurimet e Detyrueshme dhe Vullnetare të Jo-Jetës				
Shoqëria e sigurimit	Vlera (në mijë lekë)			Pesha specifike (në %) e sigurimeve vullnetare kundrejt totalit sipas kompanive
	Sigurime të detyrueshme	Sigurime vullnetare	Total	
Viti 2016				
Sigurimet e detyrueshme dhe vullnetare				
Sigal Uniqa Group Austria	2,067,751	1,875,576	3,943,328	47.56
Eurosig	1,557,395	690,222	2,247,617	30.71
Sigma Interallbanian Vienna Insurance Group	1,559,620	520,443	2,080,062	25.02
Albsig	999,882	739,060	1,738,942	42.50
Intersig Vienna Insurance Group	1,148,486	452,460	1,600,945	28.26
Insig	783,751	175,848	959,599	18.33
Atlantik	702,199	236,388	938,587	25.19
Ansig	689,665	185,594	875,259	21.20
Total	9,508,749	4,875,590	14,384,340	33.90

Tabela 2. Ndarja e Tregut në Sigurimet e Detyrueshme dhe Vullnetare të Jo-Jetës

Tendenca e shpenzimeve për dëmet e paguara bruto nga viti 2016 ka një rritje të lartë me 70.41 % si rrjedhojë e pagesave në kohë të dëmeve të mëdha të ndodhura si dhe një dëmi tek sigurimi i pronës me risigurim. Nga 16.40 % që ishte raporti dëme të paguara/prime të shkruara për vitin 2015, në fund vitit 2016 ky tregues arriti në nivelin 20.77 %. Raporti dëme/prime neto në total për vitin 2016 është 25.18 % nga 25.16 % në vitin 2015.

Dëmet e Paguara dhe Numri i Dëmeve të Paguara nga Shoqëritë e Sigurimit të Jo-Jetës							
Shoqëria e sigurimit	Numri	Vlera (në mijë lekë)	Numri	Vlera (në mijë lekë)	Ndryshimi i vlerës (në %)	Pjesa ndaj Totalit	
						(në %)	
Viti		2015		2016	16/'15-1	2015	2016
Dëme të paguara Bruto dhe Numri i Dëmeve							
Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group	3,936	786,580	3,938	1,052,084	33.75	22.80	25.70
Sigal Uniqa Group Austria	14,952	955,008	13,449	953,632	(0.14)	27.68	23.29
Intersig Vienna Insurance Group	2,752	389,299	5,095	467,219	20.02	11.28	11.41
Eurosig	2,286	645,495	3,866	458,456	(28.98)	18.71	11.20
Insig	1,562	160,034	608	407,940	154.91	4.64	9.96
Albsig	1,073	211,954	1,486	361,200	70.41	6.14	8.82
Atlantik	781	193,818	752	206,354	6.47	5.62	5.04
Ansig	1,003	107,519	1,078	186,880	73.81	3.12	4.56
TOTAL	28,345	3,449,707	30,272	4,093,765	18.67	100.00	100.00

Tabela 3. Dëmet e Paguara dhe Numri i Dëmeve të Paguara nga Shoqëritë e Sigurimit të Jo-Jetës

Edhe viti 2016 u karakterizua nga një konkurrencë e jashtëzakonshme, me efekte të ndjeshme në veprimtarinë financiare, sikundër edhe me një rritje të provigjoneve teknike për primet të pafituara neto me 206,811 mijë lekë si rrjedhojë e rritjes së primeve në vitin 2016.

U realizua një fitim bruto prej 118,251 mijë lekë për vitin 2016.

Tregueseve ekonomiko-financiare për vitin 2016

U realizuan 1, 772,219 mijë lekë të ardhura:

Të ardhurat	Realizimi në 000/lekë	Struktura e të ardhurave
Të ardhurat nga Primet	1,735,277	97.92%
Të ardhura nga investimet (interesa depozitash, llog. rrjedhëse)	9,668	0.55%
Të ardhura të tjera	27,273	1.54%
Totali	1,772,219	100%

Tabela 4. Te ardhurat e planifikuara për vitin 2017

Nga të ardhurat e veprimtarisë siguroese:

996,362 mijë lekë lidhen me sigurimin e detyrueshëm dhe 738,915 mijë lekë janë të ardhurat nga sigurimet vullnetare. Programi i miratuar për 2016 u realizua në masën **111.24 %**, me një rritje prej rreth **175,277 mijë lekë**.

Shpenzimet

Shpenzimet	Totali në mijë lekë
Shpenzime për dëme të pagura neto	289,656
Rezerva e dëmeve neto	66,747
Rezerva e primeve të pafituara_net	206,811
Shpenzime për trajtim dëmsh dhe investigime	8,686
Shpenzime risigurimi	113,010
Shpenzime të marrjes në sigurim_net	451,621
Shpenzime reklamë marketing	36,528
Shpenzime administrative	247,234
Shpenzime të tjera (F.Komp, taksa e primeve, buxheti et.)	227,452
Humje nga këmbimet	6,224
Totali i shpenzimeve	1,653,968
Përmbledhëse e të ardhurave dhe Shpenzimeve	
Prime Neto	1,415,456
Shpenzime Neto	1,327,923
Rezultati Teknik	87,533
Të ardhura të tjera	36,942
Fitim Humbje nga rivlerësimi kurseve	6,224
Fitimi Bruto	118,251

Tabela 5. Përmbledhëse e të ardhurave dhe Shpenzimeve

Raporti i shpenzimeve administrative me primet është 27.59 %. Përgjatë vitit 2016 u rritën ndjeshëm rezervat teknike për primet e pafitura, që është efekt i rritjes së shitjeve. Gjithashtu ndjeshëm në nivelin e shpenzimeve, për rrjedhojë edhe në rezultatin financiar të vitit 2016 influençoi praktika e komisioneve të marrjes në sigurim të larta, megjithë tendencën pozitive për mbajtjen e nivelit të cmimeve në treg.

3. VEPRIMTARITË KRYESORE GJATË VITIT 2016



3.1 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË ALBSIG, 2016-TA, VIT I RRRITJES INTENSIVE

Viti 2016 ka qënë dhe do të mbetet një ndër vitet me të arritshme për Albsig. Albsig përvec takimeve të njëpasnjëshme jo vetëm me drejtuesit e degëve dhe të nën-degeve të shoqërisë organizon dhe analizon punën e bërë për periudha të ndryshme. Por analiza e punës për 6-mujorin e parë të vitit është dhe ndër periudhat më kulminante të të gjitha arritjeve dhe projekteve të shoqërisë. Tashmë Albsig e ka bërë traditë analizën e punës së gjithë shoqërisë për periudhën 6-mujore të vitit. Edhe për vitin 2016 kjo analizë u realizua dhe morën pjesë të gjithë punonjësit, drejtuesit e degëve të Albsig nëpër rrethe dhe duke mos harruar dhe nëndegët e reja të sapohapura në Tiranë dhe nëpër rrethe. Analiza shërben jo vetëm për tu njohur me punën e gjithësecilit por për të krijuar dhe bërë të mundur dhe një lloj marrëdhënie më të ngushtë me secilin prej punonjësve. Përvec problemeve arritjeve dhe direktivave për ditët në vazhdim Albsig në cdo takim analizë pune shtron dhe dreka mirënjohjeje për arritjet e përfituara. Shoqëria Albsig tashmë lider në treg për sigurimin Kasko ka zënë 25.50% në total të këtij produkti në të gjithë tregun e sigurimeve për vitin 2016. Ky sigurim mbulon dhe territorin e Kosovës pa qënë nevoja për të prerë siguracion tjetër, risi kjo e cila ka bërë të mundur dhe shtimin e primit të këtij produkti. Sipas të dhënave të publikuara në analizën 1-vjeçare të Albsig, veprimtaria gjatë vitit 2016, u përqëndrua në zbatimin e prioriteteve dhe objektivave të vendosura nga Drejtuesit e shoqërisë të mbështetur nga presidenti i Kastrati Group si pjesë e fuqishme e këtij grupi biznesi, si dhe në plotësimin të detyrimeve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të Albsig.sh.a. Veprimtaria ekonomiko-financiare e vitit 2016 çoi në arritje të mëtjshme të shoqërisë që përfaqëson një subjekt të konsoliduar, konform të gjitha standarteve dhe kërkesave të akteve ligjore e nënligjore. Aktiviteti ekonomik përgjatë vitit 2016 ka shënuar progress të ndjeshëm. Është rritur prezenca e Albsig sh.a në tregun e sigurimeve jo-jetë, nga 9.91% në fundvitin 2015 në 12.09% në fundvitin 2016 kjo rrjed-

hojë e një pune shumë rezultative në linjat e produkteve vullnetare. Për linjat e detyrueshme motorike, prezenca në treg është rreth 10.52 % në fund të vitit 2016 nga 10.09 % në fund të vitit 2015. Për produktet vullnetare prezenca në treg është rritur ndjeshëm. Për vitin 2016 është 15.16 % nga 9.59 % në vitin 2015. Për vitin 2016 ka një rritje me 68.61 % kundrejt vitit 2015 në primet vullnetare. Për vitin 2016 rritja totale e tregut të sigurimeve jo - jetës është 10.25 %, ndërsa rritja e Albsig sh.a është 34.46%. Tek sigurimet vullnetare rritja e Albsig Sh.a krahasimisht me vitin 2015 është 68.61 %, ndërsa në sigurimet e detyrueshme rritja e Albsig Sh.a krahasimisht me vitin 2015 është 16.96 %. Në total rritja krahasimisht me 2015 është 34.46%. Në totalin e të ardhurave nga sigurimet kanë predominuar sigurimet e detyrueshme motorike (TPL,Kartoni Jeshil dhe Sigurimi Kufitar) që përbëjnë rreth 57.50% të të ardhurave nga primet, ndërsa produktet vullnetare 42.50 %.

Pagesat e shpejta të dëmeve, prioritet edhe në të ardhmen.

Ankesat e zakonshme të klientëve të sigurimeve janë: vonesat në pagesat e dëmeve, vlerësimi jo korrekt i dëmit, zhatje në procedura, etj. Shoqëria "Albsig sha" pjesë e Kastrati Group, si njëra nga shoqëritë më serioze në tregun e sigurimeve, duket se e ka marrë seriozisht qasjen korrekte ndaj klientëve të saj. Shlyerja e detyrimeve të dëmeve ka qënë dhe mbetet prioritet për Departamentin e Dëmeve në shoqërinë Albsig. Pas procedurave institucionale, dëmet e vogla, shlyhen brenda 3 ditëve ndërsa dëmet e tjera brenda 1-jave. Tendenca e shpenzimeve për dëmet e paguara bruto për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 ka një rritje të lartë me 70.41 %. Nga 16.40 % që ishte raporti dëme të paguara/prime të shkruara për vitin 2015, në fund vitit 2016 ky tregues arriti në nivelin 20.77 %. Raporti dëme/prime neto në total për vitin 2016 është 25.18 % nga 25.16 % në vitin 2015.



3.2 ALBSIG ON-LINE, FAQJA E WEBIT, NJË HAP PARA TË TJERËVE

Vitet e fundit, në Shqipëri, Marketingu On-line ka qënë një risi dhe vetëm së fundmi bizneset kanë filluar të përfitojnë dhe të kuptojnë avantazhet që mund të sjellë marketingu on-line, për rritjen e vizibilitetit si online ashtu edhe offline. Me evoluimin e teknologjive të reja dhe me përhapjen e internetit, ka ndryshuar mënyra me anë të së cilës përdoruesit kërkojnë dhe konsumojnë informacionet online. Rritja e përdorimit të telefonave celularë ka ndryshuar gjithashtu, mënyrën se si konsumatorët aksesojnë në internet. Sipas AKEP (Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare) në vitin 2010 përdorimi i telefonëve celulare, në Shqipëri ishte rreth 113%, dhe numri i pajtimtarëve celularë në 2014 ishte 4,881,666, gjë që tregon se numri i përdoruesve mobile është gjithnjë në rritje.

Në vitin 2015 marketingu online ka treguar se luan një rol të rëndësishëm për rritjen e aktivitetit të bizneseve, dhe ka treguar që i ofron atyre shumë avantazhe. Sot përdoruesit kërkojnë gjithmonë e më shumë informacione online përpara se të blejnë një produkt, web-i është vendi i parapëlqyer ku personat kërkojnë të mësojnë më shumë rreth produkteve dhe ku bëjnë blerje.

Çdo përdorues lë gjurmë në web, gjë që i ndihmon bizneset të kuptojnë çfarë po kërkojnë konsumatorët dhe si mund t'i përdorin këto informacione për të përmirësuar performancën e tyre online. Interneti ju ofron mundësinë të shënjestroni direkt klientët tuaj potencial, dhe marketingu online ju jep mundësinë që të reklamoni produktet duke zgjedhur një kategori personash që janë potencialisht të interesuar për atë që ju ofroni, duke përfshirë dhe Remarketing-un si një teknikë e cila ju jep mundësinë t'i shfaqni reklamat tuaja atyre personave të cilët kanë vizituar më parë faqen tuaj pa bërë blerje.

Së fundmi marketingu online ju jep edhe mundësinë të tërhiqen klientë të rinj nga çdo anë e botës pasi interneti ofron një shtrirje më të gjerë dhe një vizibilitet global.

Albsig, Web-faqe të re imazh të ri në fushën e teknologjisë së informacionit.

Në kuadrin e nxitjes së marketingut njëkohësisht dhe për një performancë me standartet e duhura në tregun e sigurimeve është bërë e nevojshme rindërtimi i web-faqes së shoqërisë përshtatur me brandin e ri si Albsig pjesë e Kastrati Group. Përbajtje dinamike e njoftimeve, artikujve, eventeve, ofertave, promovimeve të produktëve ka nxjerre në pah më shumë funksionalitetin e web-faqes së Albsig. Përdorimi me korrektesë i chatit online brenda kësaj faqeje dhe orientimi i drejtë i "klienteve dixhital" ka shtuar shumë dhe kërkesat në treg për shitjen online të produkteve të ndryshme.

Komunikim "live" përmes "chatit online" me "klientët dixhital".

Për të qënë sa më transparent dhe sa më afër klientit Albsig ka përzgjedhur të jetë sa më pranë dhe klientëve dixhital. Kërkesa për oferta të ndryshme, informacione për produktet ekzistuese dhe produktet e reja janë dhe kërkesat më të mëdha që bëhen nga klientet përmes chatit online. Numërohen qindra kontrata sigurimi të prera deri tani përmes kërkesave të ardhura përmes chatit direkt, komunikim ky i përzgjedhur nga vetë klienti. Chati është i hapur përgjatë gjithë javës dhe oraret janë të përcaktuara dhe të respektuara pothuajse nga të gjithë klientët jo vetëm ajo ekzistuese por nga ky chat është mundur të përthithë dhe një grup klientësh të rinj të apasionuar pas rrjeteve sociale.

Njoftimi on-line i ndodhjes së dëmit.

Tashmë Albsig ka më shumë se një vit që merr njoftime "online" për dëmet e kudondodhura. Të gjithë të siguruarit në Albsig dhe ata që kanë fatin jo të mirë të pësojnë dëmtime nga automjetet e siguruara në shoqërinë tonë kanë mundësi të njoftojnë për ndodhjen e rastit të sigurimit në kohë rekord. Për këtë web-faqja është pajisur me një ikonë të vecantë ku klientët dhe jo vetëm kanë në dispozicion mënyrën e aplikimit dhe të njoftimit të rastit të sigurimit për të gjitha llojet e sigurimeve përfshirë këtu rastet e sigurimit TPL dhe kasko që kanë dhe numrin me të madh të të siguruarve. Njoftim dhe ndjekje online të rastit të sigurimit dhe procedim të faturave mjekësore online. "Raporto Dëmin shëndetësor", kjo është dhe rubrika e vendosur në web-faqe për rastet e sigurimit shëndetësor. Të gjithë klientët në këtë rubrikë japin njoftimin në spitalet ku ata kanë bërë kontaktin e parë, kontrollat apo nevoja që i shtyu të kërkonin kujdesin ndaj mjekut. Gjithashtu nuk lihet pa u theksuar dhe faturat, vlerat dhe datat e sakta të këtyre faturave të bëra nga entet spitalore.

Shitje on-line të një grupi produktesh.

Përveç risive të lartpërmendura Albsig këtë vit ka bërë të mundur procesin e shitjeve online. Programimi i shitjeve online është shumë i domosdoshëm për çdo target grup klientësh në kohën e sotme. Mjafton të plotësosh statet e formulareve të kontratës online dhe vetëm me një "ok" në printim të gjithë të interesuarit do të pajisen me kontratën e kërkuar duke mos pasur nevojë të enden rrugëve për në zyrën më të afërt të shoqërisë. Njëkohësisht për një target grup tjetër ka mjaftuar të tregojnë vendndodhjen e sigurtë përmes faqes së shitjeve online dhe kontrata e tyre e duhur u ka shkuar në destinacion brenda orarit të përcaktuar nga ana e tyre. Për momentin klientët kanë mundësi të blejnë online sigurimin TPL sigurimin e shëndetit në Udhëtim, sigurimin e pronës dhe sigurimin e Shëndetit privat duke përzgjedhur kartat e shëndetit më të përshtatshme për ta dhe familjet e tyre. Njëkohësisht "klientët dixhital", duke përfshirë këtu dhe pronarët e bizneseve kanë mundësi dhe bëjnë të mundur dhe sigurimin e bizneseve të tyre. Oferta për sigurimin e pronës dhe bizneseve janë vlerësuar dhe kërkuar shumë nga një pjesë e mirë e ndjekësve të Web-faqes së www.albsig.al. Ndjekësit janë ndikuar nga njoftimet në faqen e webit për oferta të caktuara dhe më pas janë bërë menjëherë klientë të shoqërisë. Shitjet online kanë produktet e paracaktuara duke u lidhur me bankë direkt për pagesë ose duke plotësuar formularin e kërkesës për produktin e caktuar e më pas duke vërtetuar për vërtetësinë e kërkesës së kontratës, duke marrë dhe informacione konfidenciale për t'a dërguar në vendin e duhur.

Instagram, Facebook, ndër faqet më të ndjekura në rrjetet sociale.

Faqja e "Albsig Facebook" dizanjuan si një faqe e veçantë e paqyrimin të të gjitha aktiviteteve të biznesit duke përfshirë këtu dhe reklamimet e produkteve të reja si dhe të drejtat e klientëve në fusha të ndryshme. Janë realizuar fushata të ndryshme marketingu e "target grup" sipas specifikimeve të kërkuara nga ana e (grup moshave, gjinive dhe vendndodhjeve etj.) . Janë përdorur e rekomanduar aplikacione të bazuara në "nxitje" të klienteve. Të bazuar në nxitje sepse përdoruesit fitojnë ose kanë mundësi për të fituar një bonus nga aplikacioni i bërë nga ana e tyre. Ky "bonus nxitës" është menduar dhe vendosur nga vetë Albsig për të bërë sa më të mundur reklamimin e produkteve dhe për t'ju bërë me dije klientëve risitë dhe ndryshimet që mund të kenë produktet e Albsig nga shoqëritë e tjera. Instagram ashtu si Facebook është hartuar në baze të politikave të një faqe biznesi. Ndjekësit njoftohen përmes ofertave për mundësitë e përfitimit të uljeve të cmimeve për produktet e ndryshme. Ofertat janë hartuar dhe dizajnuar posaçërisht në bazë të formatit të përshtatshëm për faqen e Instagramit.



Kontakt: +355 4 2254764

Degët tona

AL EN Kërko

KREU | RRETH NESH | STRUKTURA | PRODUKTET | PUBLIKIME | PARTNERET | KONTAKTO | POLITIKAT E PRIVATËSISË

SIGURIM KASKO

MË TEPËR >



PRODUKTET TONA

Fotot ilustruese për web-faqen e re të Albsig sha



Fotot ilustruese për fan page ne Facebook te Albsig sha

3.3 ALBSIG MË I FORTË, MË I KONKURUESHËM SI PJSË E KASTRATI GROUP

Buxheti i shpenzuar për reklamat

Slogani "Ju kthen buzëqeshjen.." tashmë është i pandryshueshëm për shoqërinë, sepse kështu është pagëzuar Albsig që në gjenezën e saj, ndërsa sot jemi me një emër më të fuqishëm.

Ne sot ju tregojmë klientëve, konkurrentëve, se shoqëria është pjesë e grupit më të madh të biznesit në Shqipëri. Albsig sha si pjesë e Kastrati Group duke mbartur vlera të rëndësishme në tregun e sigurimeve, shton besimin tek klientët dhe i bën ata më të qetë dhe më të sigurtë për të investuar në fushën e sigurimeve. Për të dhënë një mesazh të rëndësishëm në komunitet Albsig ka bërë të mundur reklamimin e brandit me një buxhet të konsiderueshëm në të gjithë rrjetin ekzitues të familjes Albsig po kështu dhe në pikat e reja të sapo hapura të shoqërisë. Viti 2016 ka qënë dhe viti i "rilindjes" së pjesës më të madhe të Degëve të Albsig nëpër rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Paisja me reklame me ndriçim njëkohësisht dhe me veshje adezive e cdo zyre ka qënë dhe synimi kryesor i të gjithë fushatës sensibilizuese. Numërohen plot 10 Degë dhe nëndegë të Albsig nëpër rrethe që janë pajisur me reklamën e dezajnuar përmes brandit Albsig. Vetëm për vitin 2016 Albsig ka shpenzuar rreth 11.682.035.06 lekë për imazhin e cdo pikë shitjeje.

Investimi në imazh është vlerësuar jo vetëm nga drejtuesit e degëve nëpër rrethe por dhe nga vetë klientët nëpër degë. Investimi i imazhit është paraparë si çelësi kryesorë për hapjen e mundësive dhe ofertave të reja me biznese të ndryshme nëpër rrethe. "Nje imazh i kuruar, një bonus i përfituar" kështu janë shprehur një pjesë e madhe e drejtuesve të degëve të Albsig nëpër rrethe. Kurimin e imazhit e kanë parë si armë të fortë e konkurrencës në tregun e sigurimeve. Aktualisht investimi në imazhin e cdo zyre të shoqërisë është në zhvillim e sipër. Përveç veshjeve të jashtme tashmë janë vënë standarte dhe për veshjen e brendshme të cdo zyre. Hartimi dhe standartizimi i reklamave të brendshme ka luajtur një rol të rëndësishëm. Çdo degë apo nëndegë e Albsig tashmë është e pajisur me reklamë me ndricim të jashtëm dhe të brendshëm dhe është pajisur me reklama apo stenda të brendshme të cilat bëjnë të mundur reklamimin më nga afër e një gamë të produkteve. Vlenë për tu theksuar gama e produkteve të shëndetit për të cilën u hartuan dhe një grup reklamash shoqëruese sic janë standat e përdorura për fushatat e fillimit të shkollave dhe reklamat adezive që janë përdorur vetëm në momentin e fushatës. Kjo traditë e rifreskimit të imazhit është ndjekur dhe do ndiqet edhe për vitin 2017 për të gjitha degët, nëndegët ekzistuese dhe të reja, të hapura në të gjithë Shqipërinë. Vetëm për vitin 2016 "Imazhi i Albsig" është cilësuar si imazhi më pozitiv i përdorur nga shoqëritë e sigurimeve. Ky vlerësim është marrë dhe nga institucione e shoqata të ndryshme ku shoqata e fundit ishte shoqata e studentëve të Maqedonisë. Kjo e fundit pas një anketë të bërë nga një numër i konsiderueshëm studentësh në terren ka vlerësuar Albsig si shoqërinë me brandin më pozitiv në tregun e sigurimeve.

Brand Albsig në Tiranë dhe nëpër rrethe.



3.4 ALBSIG ME SYNIM KRYESOR REKRUTIMIN E PUNONJËSVE SA MË TË KUALIFIKUAR

Rekrutimi i punonjësve

Me rekrutim kuptojmë procesin përmes të cilit, shoqëria tenton të tërheqi një grup kandidatësh të kualifikuar në fushat përkatëse, me të cilët ajo mund të plotësojë vendet vakante të punës. Albsig ka zbatuar me përpikmëri kodin e punës duke bërë një rekrutim të standarteve të duhura dhe duke përshtar cdo kandidat për vendet e përshtatshme të punës.

2016-ta, vit që shtoi stafin e kualifikuar në Albsig

Viti 2016 do të mbahet mend si viti i zgjerimit të stafit të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig. Zgjerimi i shpejtë i rrjetit të shitjes në shoqërinë Albsig shkaktoi nevojë për të shtuar më shumë stafin e punonjësve brenda Drejtorisë së Përgjithshme të shoqërisë dhe zgjerimit të nëndegëve sidomos në Tiranë.

Ky vit ka qënë dhe viti i përzgjedhjes dhe i vlerësimit të stafit të Albsig të detajuar në bazë të Departamenteve dhe Njësive të duhura. Vetëm në vitin 2016 numërohen rreth 30 punonjës të punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Albsig dhe në nëndëget e Albsig në Tiranë.

Përzgjedhja e ekipit të punonjësve

Punonjësit në rrang drejtuesish të cilët janë punësuar në Departamentet, e Njësitë e ndryshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Albsig kanë ndikim të madh në të ardhmen e shoqërisë. Pavarësisht se sa i mirë është produkti ose shërbimi që Albsig disponon, me ekipin e duhur për të udhëzuar rritjen, biznesi s'do të dështojë kurrë por do të njohi vetëm rritje në treg. Me përzgjedhjen e stafit të duhur, mund të ofrohen shumë ide inovative për të mbajtur rritjen e vazhdueshme të shoqërisë.

Standartizimi dhe Licensimi i rrjetit të agjentëve të Albsig për vitin 2016

Albsigu për vitin 2016 i është përkushtuar shumë punës së rrjetit të agjenteve në të gjithë Shqipërinë. Qëllimi kryesor ka qënë dhe mbetet trajnimi dhe licensimi i të gjithë rrjetit të agjentëve, për të qënë në standartin e duhur njëkohësisht dhe për të bërë një punë sa më profesionale konform standarteve më të mira në tregun e sigurimeve në vend.

Agjentët janë individë të cilët bëjnë të mundur lidhjen mes klientit dhe shoqërisë së sigurimeve për arritjen e një marrëveshje apo nënshkrimin e një kontrate sigurimi. Për të operuar në treg dhe për të qënë sa më të rregullt dhe konform ligjeve agjentët pajisen më liçencë. Licensa është dokumenti zyrtar i lëshuar nga autoriteti përkatës AMF- që merret me mbikëqyrjen e sigurimeve dhe përmes saj vertetojnë se personi i pajisur me dokumentin e mësipërm është i denjë për ushtrimin e profesionin e agjentit në tregun e sigurimeve.

Albsig, 51 agjentë të licensuar për vitin 2016

Vetëm për vitin 2016 Albsig numëron plot 51 agjentë të pajisur me licensat e kërkuara dhe të standartizuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Në këtë grup agjentësh të pajisur me licensë në vitin 2016 janë të përfshirë punonjës nga i gjithë rrjeti i shitjes në të gjithë Shqipërinë. Gjithësecili prej agjentëve për tu pajisur me licensën ka kryer trajnimin e duhur pranë Shoqatës së Siguruesve miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Rëndësia e trajnimit të punonjësve në Albsig

Për drejtuesit e Albsig trajnimi i punonjësve të rinj ose jo paraqet një mundësi për të zgjeruar bazën e njohurive. Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve i japin shoqërisë në tërësi dhe punonjësve në mënyrë individuale shumë përfitime sa kostoja për punëdhënësit shndërrohet në të pa përfillshme. Kështu që një program trajnimi i ndihmon të forcojnë ato aftësi që secili prej punonjësve ka nevojë të përmirësojë. Sigurimi i trajnimit të nevojshëm ka bërë të mundur krijimin e një stafi të informuar dhe të përgjegjshëm. Kjo mënyrë pune e realizuar në Albsig i ka ndihmuar për të realizuar punën në grup. Trajnimi i vazhdueshëm gjithashtu i ka mbajtur punonjësit të përditësuar me zhvillimet e tregut të sigurimeve.

Trendi i ri i shoqërisë Albsig për rekrutimin e punonjësve të rinj pranë universiteteve

Qëllimi i pjesëmarrjes së Albsig ishte prezantimi i studentëve me produktet dhe shërbimet, njëkohësisht njohja e shoqërisë me aftësitë dhe kapacitetet që ofrojnë studentët në tregun e sigurimeve. Në këtë aktivitet prania e shoqërive pjesëmarrëse si punëdhënëse ishte e madhe. Studentët vizituan stendat duke shprehur interes për të gjitha vendet e lira, praktikatat apo intershipet e ndryshme që ofroheshin për ta. Mbi 50 kompani, nga Shqipëria dhe vendet e tjera të rajonit, morën pjesë në këtë panair. Studentë, kryesisht të vitit të fundit në 11 programe të ndryshme akademike të ofruara nga Universiteti Epoka, patën mundësi të zhvillojnë intervista pune me përfaqësues të Burimeve Njerëzore të këtyre kompanive, ndërsa studentët e viteve të tjera patën rastin të njihen me mundësitë për punësim që këto kompani ofrojnë, kërkesat e tregut të punës si dhe mundësitë e zhvillimit të praktikës mesimore.



3.5 ALBSIG RRITET E ZGJEROHET

Sigurimi Kasko, risi në tregun e sigurimeve për vitin 2016

Shoqëria Albsig tashmë lider në treg për sigurimin Kasko ka zenë 25.50% në total të këtij produkti në të gjithë tregun e sigurimeve për vitin 2016. Ky sigurim mbulon dhe territorin e Kosovës pa qenë nevoja për të prerë siguracion tjetër, risi kjo e cila ka bërë të mundur dhe shtimin e primit të këtij produkti.

Sigurimi Kasko fushata sensibilizuese e Albsig

Me daljen në treg të Sigurimit Kasko të shoqëruara me risit e saj Albsig bëri të mundur dhe realizimin e një fushate sensibilizuese për klientët. Fushata startoj në fillim të vitit 2016. Ajo bëri të mundur jo vetëm njoftimin e menjëherëshëm të klientëve për të rejat e fundit që solli "Albsig Kasko" në treg por forcoj dhe përshpejtoj rritjen e portofolit të këtij produkti.

Kjo fushatë kishte për qëllim sensibilizimin e klienteve për paisjen e automjetit tyre me sigurimin kasko dhe për përfitimet që ata marrin nga ky sigurim. Fushata është realizuar në Tiranë dhe nëpër rrethe. Nëpërmjet saj është mundur të promovohet rëndësia e këtij produkti dhe risitë që ka ky produkt solli ndryshe nga produktet e shoqërive që janë të lancuara tashme prej vitesh në treg. Fushata u pasqyrua në mediat e shkruara dhe në mediat elektronike. Mediat elektronike zënë një vend të rëndësishëm në pasqyrimin e të rejave që solli "Albsig Kasko" në treg për vitin 2016. Përmes realizimit të një spoti "Albsig Kasko" u lancua në të gjitha televizionet kombëtare.

Mini produkti më i ri "**Albsig Mini Kasko**", është sigurimi më i ri i realizuar për tju ardhur në ndihmë drejtuesve të automjeteve. Ky sigurim është sigurim i vetë automjetit motorrik për dëmtimet aksidentale që mund ti ndodhin automjetit nga përplasja e tij me një automjet tjetër, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Edhe për këtë mini produkt Albsig ka realizuar një fushatë sensibilizuese e cila bëri që klientët të njoftohen për ekzistencën e këtij produkti brenda gamës së produkteve që shoqëria Albsig zotëron tashmë në treg. Fushata "Albsig Minikasko" u përqëndrua në mediat e shkruara, mediat elektronike dhe web-faqet e lajmeve më të klikuara në vend.





- * **Demtime Aksidentale**
- * **Thyerje e Xhamave**
- * **Zjarr, Rrufe, Eksplozion**
- * **Katastrofa Natyrore**
- * **Vjedhja**
- * **Vjedhja e Pjesshme**
- * **Demtim ne Parkim pa Autor**
- * **Sigurimi Jashte Vendit**
- * **Sherbim me Karroatrec**



3.6 ALBSIG PJESË E PANAIREVE, WORKSHOPEVE DHE INTERSHIPEVE TË STUDENTEVE

Albsig në panairin, Siguri, Familje, Shtëpi, Sigurim, Punë, Biznes

05-07 Maj 2016, për kontributin e sigurisë në komunitet biznes, familje

"Safety and security" quhet panairi që mori pjesë Albsig në Maj të vitit 2016.

Konkretisht datat 5-7 Maj të vitit 2016 hapën siparin e Panairit të Parë të Sigurisë dhe Teknologjisë në Shqipëri, si përpjekje për t'i dhënë tregut një segment të nevojshëm, të domosdoshëm dhe me impakt në ekonominë e vendit.

Një dizajnim inovativ e perfekt në standartet e duhura Albsig u spikat si një ndër standat më të realizuara nga stafi organizativ i këtij eventi.

Duke nisur nga siguria që duhet të ekzistojë në çdo shoqëri apo biznes, me sisteme monitorimi apo edhe të ofrimit të mbrojtjes së shëndetit për punonjësit; deri në sistemet teknologjike të mbrojtjes së të dhënave – të gjitha këto shërbime u afruan gjatë ditëve të hapura të panairit, duke përfshirë këtu dhe Albsig-un i cili demostroj më nga afër rëndësinë e sigurimit të paketave të shëndetit dhe të sigurimit Kasko dhe minikasko te sapo lancuara.



Panairi i Sigurisë, Maj 2016

Albsig në mbështetje të aktiviteteve Sportive dhe të Studentëve



Mbetet për t'u theksuar, marrëveshja mes Fakultetit Ekonomik dhe Shoqërisë së Sigurimeve Albsig, realizuar muaj më parë, për mbështetjen e studentëve të Masterit Profesional dhe Shkencorë për kryerjen e praktikës mësimore pranë Drejtorise se Përgjithshme të Albsig. Për një periudhe 12-javore, studentët kanë mundur të jenë pjesë e stafit të shoqërisë, njëkohësisht, kanë marrë dhe suport nga vetë punonjësit e Departamenteve përkatëse pranë të cilëve, ata kanë operuar. Duke parë se praktika mësimore kërkon angazhim dhe përqendrim maksimal.

Aktualisht, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig, kanë kryer praktikën mësimore 8 Studentë të Masterit profesional dhe Shkencorë, të cilët kanë pasur fatin të mbështeten dhe të vlerësohen nga përfaqësuesi i shoqërisë.

Është viti i tretë që Albsig asiston me leksione çdo fillim shtatori nëpër shkollat e mesme profesionale dhe në disa fakultete private dhe shtetërore. Përmes disa orëve leksioni në kuadër të sigurimeve të shëndetit dhe jo vetëm Albsig ka ndërgjegjësuar një pjesë të madhe të gjimnazistëve të shkollave të ndryshme profesionale në kryeqytet të cilët kanë bërë të mundur dhe sigurimet pranë shoqërisë.

Albsig ka qenë, është dhe do të jetë mbështetëse e çështjeve të ndryshme sociale, arsimore, kulturore, letrare e artistike.

Albsig mes leaderve të ardhshëm në botën e biznesit, studentëve më të mirë



Leadership Tournament (3rd edition) was a two day event on 7-8th of May 2016, powered by AIESEC in Albania in TBU - Tirana Business University.

Companies offering workshops included Union Bank, LPA (<http://lpalbania.com/>), Albsig and M&D (<http://www.markdist.com/>).

After the presentation about the Albsig non-life insurance company a case study is presented in front of the students

10 groups about five persons were creative and continued to solve the case study.

After 3 hours the all groups presented the ideas for this case study.

The leader of the Albsig Company at last decided for the winner group.

It is pleasure to work among the Youngers

3.7 AKTIVITETET SOCIAL-KULTURORE TË SHOQËRISË

ALBSIG.sh.a vlerëson rëndësinë dhe domosdoshmërinë e Përgjegjësisë Sociale jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Shoqëria , është gjithmonë në përpjekje për të përmbushur rolin e saj social, përmes operimit me përgjegjësinë më të lartë: duke suportuar klientët në çdo hap dhe duke u dhënë zgjidhje problemeve, duke forcuar raportet me të gjithë rrethin e bashkëpunëtorëve që operojnë në të njëjtën industri dhe mbi të gjitha, duke përmirësuar cilësinë e jetës në komunitetin ku jetojmë dhe punojmë.

Për ne është e rëndësishme të tregojmë se jemi pranë shqiptarëve, jo vetëm nëpërmjet produkteve e shërbimeve që ofrojmë, por edhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në zgjidhjen e disa prej problemeve, në përputhje me vlerat e shoqërisë si dhe filozofinë drejtuese. Përmes programeve dhe nismave të ndërmarra synojmë përfshirjen e komunitetit në aktivitetet e organizuara, në sfera të ndryshme të jetës sociale.

Albsig pranë njerëzve në nevojë.

Për Albsig është me rëndësi të jetë pranë njerëzve në nevojë, duke dhënë një kontribut qoftë dhe modest në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe në lehtësimin e vështirësive social – ekonomike që ata kalojnë. Albsig ka ndihmuar me qindra njerëz në nevojë, ka financuar dhe financon shumë shoqata kryesisht: "Shoqata e Jetimëve", Fondacionin e fëmijëve që vuajnë nga autizmi, "Fondacioni i Fëmijëve Shqiptarë"etj. Albsig është bërë mbështetësja financiare për shumë probleme sociale siç ishte rasti i kontributit në shume për blerjen e apartamentit të njërit prej punonjësve të Policisë së Shtetit, kontribut ky i cili u bë i njohur përmes emisionit "Dua të të bëj të lumtur" në Top-Channel. Albsig gjithashtu ka mbështetur thirrjen dhe ju ka ardhur në ndihmë për kurim jashtë vendit një numri të konsiderueshëm personash si brenda dhe jashtë shoqërisë .

Albsig në mbështetje të zhvillimeve kulturore.

Albsig ndër vite, numëron rreth 200 libra të sponsorizuara për botim, të shkrimtareve dhe poetëve të rinjë dhe të kualifikuar në këtë fushë. Duke qenë gjithmonë e gatshme për mbështetjen e shkrimtareve Albsig këtë vit, financoi shkrimtaren e njohur znj. Bajame Hoxha Çeliku, duke bërë të mundur sponsorizimin e botimit të librit të saj

"Po pse s'të thashë...!" Duke qenë gjithmonë e gatshme për mbështetjen e artit e kulturës dhe financuese e qindra aktiviteteve kulturore, këtë vit doli në dritë Festivali i Këngës Qytetare Shkodrane, festival ky i rikthyer në skenë pas 30-vitesh harrese.

"Lule Bore", kështu është titulluar festivali i këngës qytetare shkodrane, ku mbështetja financiare nga ana e Albsig, u vlerësua shumë nga komuniteti i këtij qyteti.

Albsig ka qenë një ndër mbështetësit kryesorë të Unionit Mbarkombëtar të Integritit të Burgosurve dhe të përndjekeve politik, në aktivitetin e krijuar në kuadër të përkujtimit të klerikëve mysliman që u vranë e u burgosën gjatë regjimit komunist.

Albsig ka mbështetur dhe mbështet ngjarjet kulturore jo vetëm brenda vendit por, dhe jashtë vendit. Këtë vit ka mbështetur financiarisht Ambasadën Shqiptare në Malin e zi me rastin e festës së Flamurit.

3.8 ALBSIG GËZON E FESTON

Mesazh Urimi nga Drejtori i Përgjithshëm

"Festat e fundvitit gjithmonë priten me një emocion të madh sepse normalisht i lënë vendin gjërave negative që mund të kemi kaluar dhe i hapin dritaren një rrezeje të re drite pozitive. Urimi më i bukur për këto festa është që t'ia kalojmë bukur dhe të qëndrojmë gjithmonë të bashkuar pranë familjareve e miqve tanë të dashur dhe të jemi sa më transparente dhe korrekt me shërbimet tona ndaj klientëve. Shëndet dhe sa më shumë mbarësi, lumturi e begati. Kudo të mbizotërojë paqja, armonia dhe dashuria. Gezuar dhe mbarësi!!!". Me këtë mesazh përshendetës dhe motivues Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë së sigurimeve Albsig z. Muharrem Bardhoci përshëndet dhe i uron sa me shumë siguri, profesionalizëm, stabilitet, transparencë, përgjegjësi dhe mbi të gjitha besueshmëri stafit të tij të punonjesve."

Shoqëria e sigurimeve Albsig.sh a pjesë e Kastrati Group, e cila operon në tregun sigurimeve në Shqipëri e Maqedoni, ka vazhduar traditën duke organizuar festat e fundvitit dhe duke falenderuar punonjësit për përkushtimin në punë dhe korrektësi, transparencë dhe besueshmëri. Festat e fundvitit janë cilësuar si sezoni më kulmant për çdo punonjës. Jo vetëm kaq por kjo periudhë shikohet si "dritë jeshile" për cdo njërin nga ne. Qëllimi i këtij eventi ishte për të festuar arritjet e vitit 2016 dhe për të shpalosur direktivat për vitin 2017.

Normalisht, kur flasim për festat e fundvitit i referohemi Krishtëlindjeve dhe Vitit të Ri, dy festa të bukura me të cilat Albsig mbyll një vit dhe pret ardhjen e një Viti të ri.

Shpërblim dhe dhurata për të gjithë punonjësit.

Në Albsig festa e fund vitit bën të mundur gërshetimin e tradicionales me modernen, bën të mundur afrimitetin me punonjësit anë e mbanë Shqipërisë. Punonjësit janë ata që ndejnë më shumë atmosferën e ngrohtë të festave dhe mbështetjen e drejtuesve të shoqërisë në evente të tilla. Tashmë është bërë traditë e përvitshme dhurata dhe çmimet speciale për punonjësit sipas performancës që ata kanë shpalosur në punë përgjatë një viti kalendarik që lamë pas.



4. POLITIKAT E MONITORIMIT, ADMINISTRIMIT DHE KONTROLLIT TË RREZIKUT TË SHOQËRISË



4.1 MENAXHIMI I RISKUT, STRATEGJIA DHE POLITIKAT E MENAXHIMIT TË RISKUT

Ky raport përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në shoqerine Albsig sh.a., metodën sistematike që përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e shoqerise Albsig me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Albsig sh.a., konsideron se për të qenë efektiv, menaxhimi i riskut duhet të bëhet pjesë e kulturës së shoqerise Albsig e integruar në planet dhe veprimtaritë e përditshme të punës dhe nuk duhet parë si një program i shkëputur. Në vijim, menaxhimi i riskut duhet të bëhet përgjegjësi e çdo punonjësi në Albsig sh.a. të çdo niveli deri në hierarkinë më të lartë drejtuese. Strategjia e Menaxhimit të Riskut, fokusohet në risqet e nivelit strategjik ashtu dhe ato në nivelin operacional.

Qëllimi i Strategjisë është të sigurojë që koncepti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të kulturës organizative nëpërmjet filozofisë së zvogëlimit të riskut dhe vlerësimit të tij, për çdo veprimtari që kryen nga Shoqeria Albsig sh.a.,

Strategjia e Menaxhimit jep një qasje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar, për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar riskun. Strategjia e Menaxhimit synon të ndërtojë dhe të nxisë zhvillimin duke u bazuar në rishikime të rregullta dhe procese të përditësimit të vlerësimeve.

Menaxhimi i riskut është një proces i vazhdueshëm, që është përdorur në zbatimin e strategjisë së biznesit dhe lejon për një kuptim të duhur të natyrës dhe rëndësisë së rreziqeve, ndaj të cilave biznesi është i ekspozuar, duke përfshirë edhe ndjeshmërinë ndaj këtyre rreziqeve dhe aftësinë e tij për të zbutur ato. Duhet të sigurohet se ekziston një qasje e koordinuar dhe e integruar e menaxhimit të rrezikut në një gjuhë të përbashkët të rrezikut, që kuptohet në të gjithë biznesin.

Keshilli Mbikqyres është në fund përgjegjës për të siguruar efektivitetin e sistemit të menaxhimit të rrezikut, përcaktimin e oreksit të rrezikut dhe kufizimet e përgjithshme të tolerancës së rrezikut,

si dhe miratimin e strategjive kryesore të menaxhimit të riskut dhe politikat perkatese. Ndërsa menaxhimi i rrezikut është përgjegjësi e Keshillit Mbiqyrjes, si një e tërë, Albsig sh.a., kërkon që funksioni i menaxhimit të rrezikut duhet të raportohet te Komiteti i Administrimit te Rrezikut te shoqerise Albsig sh.a.

4.2. STRATEGJIA E RISKUT

Strategjia e biznesit mund të përcaktohet si plan i nivelit të lartë që është zhvilluar dhe specifikuar nëpërmjet politikave dhe planeve të biznesit për të siguruar zbatimin në rutinen ditore të biznesit. Strategjia e menaxhimit të rrezikut duhet të përcaktojë dhe të komunikojë qasjen për menaxhimin e rrezikut duke detajuar kuadrin, mjetet dhe qeverisjen në vend për të ofruar strategjinë e përcaktuar. Ajo duhet të ilustrojë se si kjo qasje është në përputhje me strategjinë e përgjithshme të biznesit. Strategjia e lartë e biznesit dhe niveli i rrezikut është në monitorim dhe drejtohet nga Komiteti i Administrimit te Riskut.

Strategjia e riskut përkufizohet si qasja e njësisë për menaxhimin e riskut e përcaktuar nga titullari i njësisë dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet njësia ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Duhet të miratohet nga titullari i njësisë dhe duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë:

Strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve

Mënyrën e trajtimit të risqeve në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti;

Strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij;

Kriteret për përcaktimin e risqeve madhore;

Mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

Strategjia e riskut e një njësie duhet gjithashtu të jetë në përfaqje me strategjinë e shoqerise.

Strategjia e riskut duhet po ashtu të përcaktojë oreksin e riskut të njësisë në nivel strategjik. Oreksi i riskut lidhet me nivelin e riskut që një njësi është e gatshme të lejojë (që do të thotë pranon t'i ekspozohet), në përputhje me misionin, vizionin dhe objektivat e veta, në çdo kohë, para se të vendosë nëse duhet të ndërhyjë. Oreksi i riskut ndikohet nga mjedisi i jashtëm dhe i brendshëm i kontrollit, nga njerëzit, nga sistemet e punës si dhe nga politikat.

Albsig sh.a., me ndarjen e pyetsorëve në cdo njësi dhe me përpunimin e tyre arrin që të krijojë një komunikim nëpër gjithë shoqërinë lidhur me riskun present (identifikimin) dhe me përpunimin (vlerësimin,delegimin) dhe së fundi akumulimin e gjithë këtyre risqeve në regjistrin e riskut të shoqërisë Albsig sh.a.

4.3. PARIMET KRYESORE TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT

Parimet e menaxhimit të rrezikut mbështesin qasjen e menaxhimin të rrezikut për të udhëhequr mirëmbajtjen dhe zhvillimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Shembujt përfshijnë relacione të qeverisjes së rrezikut, pronësisë së rrezikut dhe kultures së rrezikut.

4.4. OREKSI I RISKUT DHE KUFIJTË E TOLERANCËS SE RREZIKUT TË MIRATUARA

Solvency II i referohet si oreksit të rrezikut dhe rrezikut të tolerancës, këto terma nuk janë definuar në mënyrë të qartë brenda kërkesave të aftësisë paguese II apo udhëzime aktuale. Pjesa në vijim përcakton udhëzime të përgjithshme në lidhje me rrezikun e oreksit dhe rrezikut të tolerancës që merren në konsideratë. Albsig do të përdorë termin "kapaciteti i rrezikut" që do të shihet si një funksion i fuqisë financiare dhe aftësisë së menaxhimit të rrezikut.

Oreksi i riskut mund të përkufizohet si artikulumin i gatishmërisë për të marrë përsipër rrezikun, dhe duhet të fokusohet, të paktën, mbi rreziqet më materiale të biznesit.

Oreksi i riskut trajton qëndrimin e Keshillit Mbikqyres drejt rreziqeve më të rëndësishme me të cilat përballet biznesi. Kufijtë e tolerancës së përgjithshme të rrezikut mund të përcaktohen si kufizime të menaxhimit që i imponon në vetvete marrjen e ketyre rreziqeve. Kjo mund të përfshijë kufizime të detajuara të mbështetura nga proceset e monitorimit dhe udhëzon për vendime të marra ditë pas dite të bera në përputhje me metrikat e oreksit të rrezikut të përgjithshëm.

Çdo kategorizim i rrezikut duhet të trajtohet nga kombinimi i oreksit të rrezikut dhe tolerancës. Është e rëndësishme që orekset e rrezikut dhe tolerancat të jenë të komunikueshme në mënyrë të qartë për të gjithë menaxherët dhe stafin përkatës në të gjitha nivelet.

4.5. PËRMBUSHJA E POLITIKËS SË MENAXHIMIT TË RISKUT

Realizohet ndërmjet:

Detyrim i drejtuesve është monitorimi dhe verifikimi periodik i risqeve që kërcënojnë realizimin e qëllimeve kryesore strategjike.

Personat përgjegjës për menaxhimin e riskut duhet të kenë kualifikimin e nevojshëm për identifikimin e riskut dhe për vlerësimin e tij.

Punonjësit kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

Çdo veprim i punonjësit i cili ka për qëllim marrjen përsipër të përgjegjësisë për riskun do të vlerësohet dhe sipas gjykimit të mbështetet nga drejtuesit.

Raportimi për çdo lloj ngjarje, si pozitive, ashtu dhe negative është detyrim i çdo punonjësi.

Duhet të sigurohet që politikat e menaxhimit të riskut:

- Të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Standardet e Qeverisjes së shoqërisë.
- Të përcaktojnë dhe kategorizojnë rreziqet materiale sipas llojit të biznesit që është ekspozuar;
- Të përcaktojnë kufijtë e miratuara, tolerancën e rrezikut për çdo lloj të rrezikut;
- Të zbatojnë strategjinë e rrezikut;
- Të lehtësojnë mekanizmat e kontrollit; dhe
- Të marrë parasysh natyrën, fushëveprimin dhe shtrirjen e kohës së biznesit dhe rreziqet e lidhura.
- Të mbulojnë të gjitha rreziqet materiale, duke përfshirë rreziqet e reja, rreziqet e llogaritshme ose jo - të llogaritshme dhe reputacionit strategjik kur është e nevojshme;
- Të konsiderojnë akumulimin potencial dhe ndërveprimet e riskut;
- Të përcaktojnë procesin dhe frekuencën e stresit dhe skenar testet e rregullta dhe të përshkruajnë situatat për skenar teste të veçanta.



Dokumentacioni i tyre mbulon fushat e përcaktuara në lidhje me sa më poshtë:

- Marrjen ne sigurim dhe rezervimin e rrezikut;
- Menaxhimi i aktiv-pasiv;
- Rreziku i investimit;
- Rreziku i likuiditetit;
- Rreziku i përqendrimit (dmth grumbullimi i ekspozimeve të rrezikut brenda dhe në mes të kategorive të rrezikut);
- Rreziku operacional; dhe
- Risigurimi dhe teknika të tjera lehtësuese.

Kuadri i Administrimit të Rrezikut

Shoqëria Albsig Sh.a mbikëqyret dhe kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe Këshilli Mbikëqyrës. Kompetencat e këtyre organeve drejtuese përcaktohen në Statutin e Shoqërisë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

Albsig sh.a, ka vendosur objektiva të qarta për periudhën 1-vjecare dhe rritja e sigurisë për arritjen e tyre kërkon menaxhimin e realizimit të objektivave. Kjo kërkon vendosjen dhe zotërimin e një metode të koordinuar dhe të planifikuar ndaj menaxhimit të rrezikut, identifikimit, analizimit dhe reagimit ndaj rreziqeve me të cilat ballafaqohet shoqëria. Këtu merr kuptim Politika e Menaxhimit të Riskut e cila kërkon që të shqyrtohet jo vetëm natyra e rreziqeve por dhe kuptimi i koncepteve kryesore të menaxhimit të riskut.

Struktura organizative dhe përgjegjësitë e rrezikut

Çdo njësi e qeverisjes duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht (të pakten një herë në 1vjet) si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme.

Për të menaxhuar riskun, duhet bërë menaxhimi i proceseve eventualisht në strukturat përkatëse. Risku është pasiguria e rezultatit dhe një menaxhim i mirë i riskut lejon:

Të rritet besimin në arritjen e rezultateve të dëshiruara

Të trajtohen kërcënimet në mënyrë efektive në nivele të pranueshme;

Të merren vendime të informuara mbi shfrytëzimin e mundësive.

Menaxhimi i mirë i riskut u lejon grupeve të interesit të rrisin besimin në qeverisjen e shoqërisë dhe aftësinë ofruese të saj¹.

Një strukturë e tillë është zakonisht referuar si modeli i "tre linja e mbrojtjes."

Një strukturë efektive në mënyrë tipike do të ketë llogaridhënie të qartë dhe pritjet që do të ndihmojë për të arritur objektivat e biznesit për të siguruar vendime që janë të koordinuara në përputhje me deklaratimet e oreksit të rrezikut dhe politikat. Shqyrtim i kujdesshëm duhet t'i jepet shpërndarjes dhe komunikimit të roleve, përgjegjësive kundrejt biznesit, si dhe vendosjen e rregullave dhe proceseve të riskut bazuar në vendimmarrje dhe raportime për të siguruar që të jene të përshtatshme. Është e rëndësishme që të gjitha palët e lidhura të kuptojnë rolet e tyre, përgjegjësitë dhe llogaridhënie; duke përfshirë edhe atë që pritet prej tyre dhe autoritetit për vendimmarrje në raportimin (dmth çdo individ përkatës është në gjendje të shpjegojë se cilet janë përgjegjës për të, në çfarë mënyrë dhe si lidhen.

Një strukturë organizative mbështetet në administrimin efektiv të rrezikut. Struktura duhet të jetë e përshtatshme, zakonisht duhet të ofrojë tri nivelet e qeverisjes në lidhje me rrezikun:

Përgjegjësi direkte për menaxhimin dhe kontrollin e rrezikut (p.sh. stafit dhe menaxhimit të punës ne njesite ne perballje me klientet /konsumatoret)

¹ The Orange Book: Management of Risk - Principles and Concepts (HM Treasury, 2008)

Koordinimi, lehtësimi dhe mbikëqyrja e efektivitetit dhe integritetit të strukturës së administrimit të rrezikut (p.sh. komiteti i rrezikut dhe funksioni i menaxhimit të rrezikut); Dhe Sigurimi i sigurimit të pavarur dhe sfidë në të gjitha funksionet e biznesit në lidhje me integritetin dhe efektivitetin e strukturës së administrimit të rrezikut (p.sh. auditimit të brendshëm dhe të jashtëm).

Duhet të sigurohet që ofrohen mjetet e duhura të menaxhimit të rrezikut, të cilat janë lehtësisht të arritshme, për të mbështetur proceset dhe stafin e tyre. Trajnimi i duhur dhe zhvillimi duhet të sigurohen, për të gjithë stafin, përreth të gjitha aspekteve të qasjes për menaxhimin e rrezikut.

Struktura organizative duhet të lehtësojë qarkullimin e informacionit korrekt të riskut rreth biznesit në kohën e duhur, dhe duhet të ketë procese në vend që merren me çështjet e rrezikut. Për të qenë efektiv, proceset e shkallëzimit zakonisht të jenë të arritshme për të gjithë dhe kanë të qarta të përcaktuara, procedurat, pikat e alarmit dhe pikat e përshkallëzimit. Është e rëndësishme për të siguruar që konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e informacionit është ruajtur, veçanërisht në lidhje me këto procese të rëndësishme për suksesin e biznesit.

Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e riskut

Menaxhimi i riskut duhet të bëhet pjesë e kulturës së përditshme të performacës së drejtimit. Rëndësi të veçantë në këtë proces ka përcaktimi i strukturave përgjegjëse për menaxhimin, raportimin dhe monitorimin e risqeve.

Roli dhe përgjegjësitë në menaxhimin e riskut, të ndara sipas grupeve paraqiten në tabelën në vijim. Në përcaktimin e strukturave dhe përgjegjësisë për çdo grup, jemi bazuar në kuadrin ligjor e nënligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësitë e shoqërisë Albsig sh.a.

Grupet	Roli
Komiteti i administrimit të rrezikut	Është përgjegjës për menaxhimin e procesit të riskut të të gjitha njësive pjesë perberese e departamenteve të shoqërisë Albsig sh.a., ngritjen e strukturave dhe marrjen e vendimeve konkrete në çdo rast.
Drejtor i departamentit të menaxhimit të riskut dhe IT	Është përgjegjës për këshillimin dhe dhënien e instruksioneve menaxherëve të tjerë të njësisë. Bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësive dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij. Të sigurohet që risku është menaxhuar në mënyrë efektive në të gjithë njësinë dhe të raportojë te Komiteti i Administrimit të Rrezikut si dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë
Drejtuesit e njësive të departamenteve	Monitorimin dhe kontrollin e risqeve brenda njësive që drejtojnë dhe të raportojnë tek departamenti i Menaxhimit të riskut, se si risqet janë menaxhuar.
Punonjës në nivel menaxheriale në çdo njësi	Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.
Auditimi i Brendshëm	Të kryejnë auditime për të siguruar se risqet po menaxhohen nga njësitë në mënyrë efektive. Të sigurojnë këshillimin dhe mbështetjen e nevojshme, nëpërmjet ekipit të punës për menaxhimin e riskut në njësite të shoqërisë.
Komiteti i Auditimit të Brendshëm të shoqërisë Albsig sh.a.	Raportimi i problemeve të Komitetit i Auditimit të Brendshëm të shoqërisë për tu menaxhuar në përmesim të punës së departamenteve.

Tabela 6. Roli dhe përgjegjësitë në menaxhimin e riskut, të ndara sipas grupeve

Funksionimi i strukturës qeverisëse të rrezikut duhet të sigurojnë mbikëqyrje adekuate dhe sfidë për të siguruar që rreziqet po menaxhohen në mënyrë të përshtatshme në përputhje me oreksin e rënë dakord. Kjo kërkon që konsideratat e duhura që rrezikojnë çështjet në nivelin e Keshillit Mbikëqyrës, si dhe raportimin e duhur nëpërmjet strukturese së Komitetit të Administrimit të Rrezikut. Është përgjegjësi për përcaktimin e strukturën më të përshtatshme të qeverisjes, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar që çdo anëtarë me ekspertizë të përshtatshme dhe përvojë, me kushtet e duhura të referencës dhe autoritetit për të vepruar te jete pjese në çështjet me të rëndësishme. Është praktikë e zakonshme që të krijohet një Komitet i Administrimit të Rrezikut me mbikëqyrjen e të gjithë strukturës së administrimit të rrezikut për të siguruar që rreziku është në vëmendje të mjaftueshme dhe të përqëndrohet.

Struktura e administrimit të rrezikut e paraqitur sipas komiteteve dhe funksioneve që kontribuojnë në sistemin e administrimit të rrezikut si më poshtë:

Prej muajit Tetor 2015 shoqëria ka vënë në funksionim Komitetin e Administrimit të Rrezikut, në përbërjen e të cilit janë Drejtori i Menaxhimit të Riskut dhe IT, Drejtori i Departamentit të Marrjes në Sigurim të Pronës dhe Risigurimit, Drejtori i Departamentit të Marrjes në Sigurim për Produktet Motorike dhe Administrimi i Rrjetit, Drejtori i Financës dhe Kontabilitetit dhe Drejtori i Dëmeve. Komiteti i Administrimit të Rrezikut ka autoritetin dhe përgjegjësinë që të drejtojë dhe koordinojë të gjitha funksionet e administrimit dhe vlerësimit të rrezikut.

Komiteti i Administrimit të Rrezikut është përgjegjës për rishikimin e politikave të administrimit të rrezikut të shoqërisë dhe kapacitetin e limiteve të rrezikut, si dhe për monitorimin e tolerancës ndaj rrezikut, rishikimin e linjave të bizneseve me rrezik të lartë dhe ekspozimin ndaj tyre. Komiteti i Administrimit të Rrezikut raporton periodikisht në bazë 3 - mujore tek Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë. Në strukturën organizative të shoqërisë që prej vitit 2010 funksionon Departamenti i Menaxhimit të Rriskut dhe IT.

Departamenti i Menaxhimit të Rriskut dhe IT ka si detyrë kryesore identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e rreziqeve të shoqërisë dhe të përcaktuara si më poshtë:

Ushtron autoritetin për të kryer përgjegjësitë në mënyrë të pavarur nga menaxhimi i përditshëm i rreziqeve;

Bashkërendon veprimtaritë që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të shoqërisë Alb-Siguracion sh.a dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij (regjistri i riskut);

Krijon, mban dhe zhvillon një plan gjithëpërfshirës të menaxhimit të rrezikut, duke pasur parasysh integrimin e menaxhimit të rrezikut në të gjitha operacionet dhe administratën e shoqërisë Alb-Siguracion sh.a.;

Mbikëqyr administrimin e rreziqeve në veprimtaritë e shoqërisë Alb-Siguracion sh.a. duke siguruar që të ketë proces efektiv;

Orienton Drejtorët e Departamenteve, me anë të analizave përkatëse të rrezikut, në rastet e vendim-marrjeve të rëndësishme;

Studion dhe krahason marrëdhëniet midis të dhënave në një moment kohor dhe tendencës së atyre marrëdhënieve në periudha kohore, duke hartuar disa pritshmëri për marrëdhëniet e rëndësishme financiare dhe operacionale;

Së bashku me Menaxhimin e Lartë, ndjek çështjet e identifikuara që lidhen me administrimin e rrezikut dhe rekomandimet e bëra;

Monitoron në mënyrë të vazhdueshme pozicionet e rrezikut kundrejt kufijve të miratuar dhe sigurohet që shkeljet e konsiderueshme të trajtohen menjëherë;

Ushtron përgjegjësi për identifikimin e rreziqeve të konsiderueshme, vlerësimin dhe analizën e kë-

tyre rreziqeve, dokumentimin e rezultateve të analizës dhe hartimin e rekomandimeve dhe Menaxhimin e Lartë për mënyrën se si mund të zbatohet analiza në monitorimin e vazhdueshëm të shoqërisë Alb-Siguracion sh.a.

Bashkëpunon me Menaxhimin e Lartë për menaxhimin e riskut, duke kontrolluar edhe aktivitetin e tregut në mënyrë që të merren vendimet e duhura për investimet, në përputhje me riskun ekzistues. Siguron të dhëna për prioritetet që duhet të ketë shoqëria Alb – Siguracion sh.a. për periudha afatmesme dhe afatgjata.

Paraqet planin e përgjithshëm të risqeve të shoqërisë Alb-Siguracion sh.a. tek Drejtori i Përgjithshëm dhe me propozim të Drejtorit shqyrtohet dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

U jep raporte të rregullta Drejtorit të Përgjithshëm dhe Menaxhimit të Lartë, mbi efektivitetin e proceseve të administrimit të rrezikut të shoqërisë Alb-Siguracion sh.a., si dhe u jep informacion në kohë për ngjarje të rëndësishme që lidhen me tregun e sigurimeve, në përgjithësi, dhe me shoqërinë Alb-Siguracion sh.a., në veçanti;

Ushtron përgjegjësi të tjera të përditshme për administrimin e rrezikut në Alb- Siguracion sh.a, sipas përcaktimeve në urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm.

Shoqëria ka krijuar dhe funksionin e pajtueshmërisë në strukturë në përbërje të Departamentit Juridik, që monitoron përputhjen e veprimtarisë me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Raportimet janë rast pas rasti.

Komiteti i Auditimit në shoqëri funksionon prej muajit korrik 2015. Në procesin e vetëvlerësimit janë gjetur mangësi. Për eliminimin e mangësive dhe në kuadër të përputhjes me legjisllacionin në fuqi, është miratuar rregullorja e funksionimit të Komitetit të Auditit të brendshëm, të cilat konceptojnë një strukturë të Komitetit të Auditimit në përputhje me praktikën më të mira të auditit të brendshëm dhe legjisllacionin e sigurimeve. Komiteti i Auditimit ndihmon Këshillin Mbikëqyrës në përmbushjen e funksioneve të veta mbikëqyrëse kundrejt aksionerëve dhe palëve të interesit.

Funksioni i auditit të brendshëm rishikon dhe vlerëson mjaftueshmërinë e proceseve të administrimit të rrezikut, qeverisjes dhe kontrollove të brendshme, si dhe pajtueshmërinë me kuadrin ligjor/rregullator.

Funksioni i Aktuarit rekomandon metoda dhe procedura për të vlerësuar provigjonet teknike, primet dhe nivelet e tyre si dhe përputhshmërinë me kërkesat statutoare dhe rregullatore. Aktuari raporton në periudha tremujore tek Drejtori i Menaxhimit të Rriskut dhe IT dhe tek Drejtori i Përgjithshëm.

Shoqëria Albsig Sh.a. ka filluar menjëherë përshtatjen edhe pse sistemi i administrimit të rrezikut dhe ndërtimi i strukturave të vecanta për administrimin e rrezikut është një risi për legjisllacionin dhe tregun shqiptar të sigurimeve. Shoqëria ka një strukturë të përshtatshme për administrimin e rreziqeve nisur nga nga procesi i vetvlerësimit dhe testimit të strukturës aktuale.

Strategjia e shoqërisë bazohet tek rreziqet kryesore që pengojnë objektivat strategjike të biznesit, si dhe tek rreziqet e tjera që administrohen në bazë ditore, duke përcaktuar në këtë mënyrë tolerancën ndaj rrezikut.

Departamenti i Menaxhimit të Rriskut dhe IT është përgjegjës për zbatimin e planit të menaxhimit të rrezikut në bashkëpunim me funksionet e tjera operacionale që janë përgjegjës për pikat e përcaktuara në plan për tu zbatuar. Departamenti i Menaxhimit të Rriskut dhe IT mbështetet edhe në analizat e proceseve të kryera nga njësia e auditit të brendshëm.

Përveç funksioneve të përcaktuara si më sipër në administrimin e rrezikut, cdo punonjës gjatë ushtrimit të funksioneve të tij ka në vëmendje rolin e tij në identifikimin dhe zbutjen deri në eliminimin e rreziqeve sipas përcaktimeve të përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësisë.

Kuadri i raportimit

Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut dhe kontrollit, duhet të marrë masat e duhura sipas nevojës. Ka një numër të mënyrave të cilat mund të përgjigjen ndaj rrezikut, duke përfshirë:

- Transferimi i nje pjesë te rrezikut; për shembull, duke blerë sigurim ose risigurim;
- Trajtimin ose zbutje te riskut; dmth të zvogëlojë gjasat dhe / ose ndikimit të tij;
- Të pranojë ose të tolerojë nivelin aktual të rrezikut, ku rreziku i afrohet apo është në kufijtë e tolerancës së rrezikut. Kjo mund të jetë e përshtatshme ku zbutja e nivelit aktual te rrezikut është në disproporcion me përfitimet.
- Eliminimin ose të përfundimin;
- Nivelet e oreksit të rrezikut ne ndryshimin apo tolerimin e shkeljes për një kohë të shkurtër (në këtë rast arsyetimi duhet të dokumentohet). Kur përcaktimi i përshtatshmërisë së përgjigjeve të rrezikut konsiderohet si në vijim:
Fizibiliteti dhe kostot relative (direkte, indirekte dhe mundësite) dhe përfitimet e opsioneve alternative të reagimit të rrezikut, kostoja për të hartuar dhe zbatuar një kontroll të ri dhe kostoja në vazhdimësi e kontrollit;
- Aspektet cilësore të rrezikut, të tilla si ndikimi mbi rrezikun e reputacionit;
- Nevojën për të siguruar që përgjigjet janë bazuar në një kuptim të plotë të rrezikut dhe komponentëve të tij, veçanërisht shkaqet e rrezikut, për të siguruar ato që janë të adresuara;
- Nëse rreziqet nuk mund të kontrollohen për nivele të pranueshme duhet të shmangen, ose plane te vazhdimësisë se zhvillimit te krijohen.

Në programin e administrimit të rrezikut identifikimi i rreziqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim e të gjitha rreziqeve të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria. Shoqëria fokusohet tek rreziqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjikë.

Këto rreziqe janë pjesë e procesit të administrimit të rrezikut për periudhën. Pjesë e procesit të administrimit të rrezikut janë dhe rreziqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme.

Rreziqet e pranishme në shoqëri janë të përfshira në një prej kategorive të identifikuar më poshtë.

3.1 SISTEMI I RAPORTIMIT

Eshte i bazuar në informacionin që merr nga deget /rrjeti i degëve/zyrave,/pikave të shitjes raportim cdo mujor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të shoqërisë Albsig.

Përveç kësaj, në situata kur ndodhin ngjarje të caktuara, të cilat kanë ndikim tek menaxhimi i riskut të brendshëm, çdo punonjës ka detyrimin për të informuar lidhur me këtë fakt. Drejtorin e menaxhimit të Riskut dhe IT.

Kategoritë e rreziqeve

Duhet të sigurojnë që miratimi i proceseve për identifikimin e rrezikut dhe vlerësimin janë të përshtatshme duke pasur parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve presente në biznes. Është e rëndësishme për të siguruar që individët e duhur nga i gjithë biznesi janë të përfshirë që te kuptojnë aspektet e lidhura. Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve duhet të dokumentohen në mënyrë të qartë.



PJESË E
KASTRATI GROUP

1. Identifikimi i rrezikut

Identifikimi i rrezikut është një komponent kyç i një kornize të fuqishme të menaxhimit të rrezikut. Si një hap i parë në këtë procesi duhet të sigurohet që të kenë një kuptim të qartë të universit të tyre të rrezikut. Kjo mund të përkufizohet si dokumentimin i llojeve të ndryshme të rrezikut të biznesit. Një proces efektiv i identifikimit të rrezikut do të:

- Identifikojë rreziqe të konsiderueshme për arritjen e objektivave të biznesit;
- Të identifikojë të gjitha llojet e rrezikut, komponentet kryesore të lidhura dhe kontrollet aktuale në vend, nga të gjitha burimet, në të gjithë gamën e aktiviteteve
- Të identifikojë rreziqet rreth mundësive, si dhe kërcënimeve, për të rritur mundësinë e maksimizimit të përfitimit të mundësive, kur ato të lindin;
- Të sigurojë që menaxhimi është i vetëdijshëm për rreziqet e saj të mëdha në çdo moment në kohë, dhe përfshin elemente të rinovuar të të kuptuarit të rrezikut në mënyrë të vazhdueshme,
- Fokusohet mbi shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në rrezikun, si të jashtëm dhe të brendshëm si dhe efektet, rezultatet e saj;

2. Vlerësimi cilësor dhe sasior i rrezikut

Vlerësimi i rrezikut mundëson një kuptim më të madh të rrezikut dhe është jetike për procesin e marrjes së vendimeve të bazuara në risk, duke ofruar:

- Krahasimi i rreziqeve kundër njëri-tjetrit, duke ndihmuar për të përcaktuar përparësitë e rreziqeve në drejtim të fokusit dhe vëmendjes që duhet të jepet ndaj rreziqeve të veçanta;
- Krahasimi kundër oreksit, duke nxitur veprime korrigjuese dhe ofruar siguri ndaj statusit "në kontroll" të organizatës;
- Kosto kundrejt përfitimit analizën e aktiviteteve me rrezik të marrjes dhe mundësitë alternative të kontrollit; dhe
- Të dhëna të vlefshme në procesin e vlerësimit të kapitalit.

Një vlerësim efektiv të rrezikut në mënyrë tipike do të rishikohen rregullisht për të siguruar që ajo qëndron e rëndësishme dhe e përshtatshme për natyrën dhe nivelin e rrezikut në kuadër të biznesit. Frekuenca e rishikimit duhet të reflektojë profilin e rrezikut të biznesit, dhe mund të jetë në mënyrë tipike tremujore apo gjashtë-mujore.

Duhet të sigurohet që përdorim një metodë të përshtatshme të vlerësimit e cila mund të jetë cilësore apo sasore, ose një kombinim i të dyjave. Metoda e duhur do të varet nga një numër faktorësh, duke përfshirë natyrën e rrezikut dhe politikën e rrezikut. Çfarëdo metodash janë zgjedhur, duhet të jetë në gjendje të demonstrojë efektivitetin dhe përshtatshmërinë e kritereve të saj të vlerësimit. Risqet analizohen duke konsideruar gjasat dhe impaktin, si një bazë për të vendosur se si ato do të menaxhohen në vijim. Risqet vlerësohen në baza të qenësishme dhe të mbetura.

Në vlerësimin e risqeve Albsig orientohet nga tre parimet bazë:

Siguria se ka një proces të strukturuar qartë në të cilin si mundësia edhe impakti, konsiderohen, për secilin risk;

Regjistrimi i vlerësimit të riskut në një mënyrë që lehtëson monitorimin dhe identifikimin e prioritetëve të riskut;

Qartësimi mbi ndryshimin ndërmjet riskut të qenësishëm dhe riskut të mbetur;

Disa lloje të riskut janë vlerësuar sipas një diagnostikimi numerik – veçanërisht risku financiar. Për risqet e tjerë – për shembull risku i reputacionit – ajo më e mundshme është një pikëpamje e përgjithshme subjektive.

Vlerësimi është bërë mbi evidence të pavarur dhe të paanshme, duke konsideruar perspektivat e

të gjithë shkallës së pjesëmarrësve të ndikuar nga risku dhe të shmangë konfuzionin e vlerësimit objektiv të riskut me gjykimet mbi pranueshmërinë e riskut. Pas identifikimit risqet janë përfshirë në regjistrin e riskut ku përcaktohet zotëruesi i riskut dhe hapat që do të ndërmerren për të zbutur ndikimin e këtij risku. Risqet janë kategorizuar ndaj ndikimit të mundshëm në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 është ndikimi më të ulët dhe 10 ndikimi më i lartë si dhe janë kategorizuar kundrejt gjasave të ndodhjes në një shkallë nga 1 deri në 10, 1 janë gjasat më të ulta dhe 10 gjasat më të larta.

Ndikimi i Riskut dhe gjasat e Riskut paraqesin vlerësimin e riskut, ku 100 është risku më i lartë i mundshëm, sipas shkallëve klasifikohet në tabelën e mëposhtme.

Ndikimi i Riskut	Niveli	Frekuenca e Analizës
Nuk vepron	< 10	-
Monitorohet për t'u menaxhuar	< 20	3 mujore
Monitorohet për t'u menaxhuar	< 30	3 mujore
Jo i rëndësishëm, por mund të ketë efekt në realizimin e detyrave	< 40	Mujore
Mund të ketë efekt në realizimin e detyrave	< 50	Mujore
Risqe të rëndësishme – mund të ndikojnë në realizimin e detyrave	< 60	Javore
Risk kyç – ndikon në realizimin e detyrave kryesore	> 60	Menjëherë
Duhet veprim i menjëhershëm - kërcënon realizimin e detyrave kryesore	> 80	Menjëherë

Tabela 7. Vlerësimi i riskut

Metodologjia e ndjekur

Si pjesë e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut çdo Departament. Auditimi dhe Drejtori, përpilojnë Regjistrin e Riskut.

Në përcaktimin e risqeve të auditimit angazhohet i gjithë stafi auditues duke filluar nga audituesit sipas detyrave, që në fazën e hartimit të programit të auditimit. Këto risqe diskutohen në nivel departamenti/drejtorie dhe seleksionohen. Departamentet/Drejtoritë mund dhe duhet të përcaktojnë shumë risqe, ku parashtrihen përparësitë e risqeve dhe afatet për trajtimin e tyre.

Për thjeshtësi riskun në një veprimtari njerëzore po e konsiderojmë si mundësi për të humbur ose për t'u dëmtuar, etj nga produkti që do të realizojë veprimtaria.

Pak më ndryshe, risku në çdo veprimtari, ka lidhje me humbjen, dëmtimin, rreziqet, etj të produktit që do të realizohet në të ardhmen.

Që këtej:

-së pari, rrënjët e riskut duhen kërkuar tek veprimtaria njerëzore

-së dyti, meqenëse kjo veprimtari "do të kryhet në të ardhmen" dhe shoqërohet me humbje, dëm-

tim, rrezik, etj nga produkti, risku duhet të parashikohet, vlerësohet; njëherësh edhe te merren masat për kufizimin ose zvogëlimin e tij.

Meqenëse çdo veprimtari njerëzore është një "ndryshim, atëherë rrënjët e riskut duhen kërkuar pikërisht në këtë ndryshim (më saktë tek ndryshimi i vetisë, atributit, etj).

Vlerësimi i riskut është një proces i vështirë që kushtëzohet nga shumë faktorë. Faktorët shqyrtohen në shumë nivele, përfshirë këtu subjektin njerëzit (sjelljen) ndarjet, gjeografinë produktet apo shërbimet, proceset e kontabilitetit dhe të veprimtarisë, kontrollet ose sistemet e kompjuterizuara.

Më poshtë po përmendim disa prej tyre:

Lloji i procesit: i thjeshtë, i përbërë, i përzier, parësor, jo-parësor, homogjen, johomogjen, etj;

Dinamika e procesit në hapësirë me një e shumë përmasa, kohë, etj;

Tipi i objektit ku ndodh procesi;

Natyra e informacionit, të dhënat, lloji, saktësia, vëllimi e cilësia, struktura, etj. Bazat e të dhënave, magazinat e të dhënave, etj;

Metodikat e matjes, instrumentet e matjes, gabimet e matjes, etj;

Metodikat e grumbullimit, seleksionimit dhe trajtimit të të dhënave;

Modeli dhe metodikat matematikore, informatika, analiza e ndjeshmërisë, statistikë, fuzzy, metoda e kontrollit, rrjetat e Bejesit, etj.

Menaxherët e të gjitha niveleve duhet të vlerësojnë secilin nga risqet e identifikuar në drejtim të mundësisë së ndodhjes dhe të ndikimit mbi objektivat, si më poshtë vijon:

Mundësia që risku të ndodhë, lidhet me probabilitetin që ngjarja e pafavorshme të ndodhë, nëse nuk ka aktivitete kontrolli që do ta parandalonin, ose do të pakësonin riskun. Mundësia që risku të ndodhë duhet të vlerësohet për secilin nga risqet e identifikuar me tri shkalle ("i lartë, i mesëm, ulët")

Ndikimi është efekti që një ngjarje e pafavorshme do të kishte mbi njësinë, nëse ngjarja do të ndodhte vërtet. Një efekt i tillë do të ishte ose një lloj dëmi, ose një lloj shansi i humbur. Nëse është e mundur, efekti duhet të përlogaritet në formë sasiore. Por minimalisht, efekti duhet të përshkruhet në mënyrë aq konkrete, sa të tregojë rëndësinë e riskut. Ndikimi duhet të vlerësohet me tri shkalle ("i lartë, i mesëm, ulët")

Vlerësimi i secilit risk duhet të rishqyrtohet të paktën një herë në vit, por edhe më shpesh në vartësi të ndikimit që ka në realizimin e objektivave

Gjatë vlerësimit të riskut duhen marrë parasysh raporti i kostos për aktivitetet e kontrollit që do të ndërmerren ndaj përfitimeve lidhur me reduktimin e riskut.

Metodat cilësore janë përdorur shpesh për të lehtësuar vlerësimin e rrezikut dhe për të nxitur diskutimin. Ato përdoren edhe kur ka të dhëna të mjaftueshme për të kryer vlerësime më sasiore, ose kur gjykimi subjektiv është më i nevojshëm.

Metodat e vetë-vlerësimit janë duke u përdorur, duhet të ketë procedura për të siguruar sfida dhe mbikëqyrje për të siguruar gjykimin duke aplikuar në mënyrë konsistente në të gjithë shoqërinë. Kjo është e rëndësishme pasi nuk mund të jetë një diversitet i rëndësishëm në perceptimet paragjyquese të rrezikut nga personi në person. Duke pasur parasysh natyrën subjektive të vlerësimeve të tilla, treguesit kryesorë dhe analizat e humbjes mund të jetë me dobi për të vërtetuar ose sfiduar.

Mjetet sasiore mbështeten në disponueshmërinë e një sasi të mjaftueshme të të dhënave të besueshme historike. Ku ka të dhëna të brendshme të pamjaftueshme, përdorimi i një bazë të dhënash të jashtme mund të japë disa përfitime. Gjithsesi shqyrtimi me kujdes i të dhënave të jashtme është e përshtatshme për profilin e rrezikut dhe e rëndësishme për rreziqet e veçanta që po vlerësohen. Për më tepër, duhet gjithashtu të marrin në konsideratë se ka pak kontroll mbi plotësinë dhe saktësinë e informacionit të hartuar në një bazë të dhënash të jashtme

Përdorimi i bazave të të dhënave të brendshme duhet të trajtohet me një element të kujdesshëm pasi performanca historike nuk është domosdoshmërisht një tregues i ngjarjeve të ardhshme.

Prandaj, duhet të merren parasysh ndryshimet e mundshme në mjedisin e rrezikut dhe kontrollit, shkaqet e rrezikut, ndikimet dhe probabilitetet me kalimin e kohës.

3. Kontrollat e brendshme

Aktivitetet e kontrollit veprojnë në të gjitha nivelet brenda shoqërisë për të zbutur rreziqet në nivele të pranueshme. Kontrollat mund të përfshijnë politikat, procedurat, sistemet dhe proceset për të gjithë organizatën. Kontrollat efektive janë zakonisht:

- Të përshtatshme dhe në proporcion me rreziqet kryesore me të cilat përballen në të gjitha nivelet, në mënyrë që të sigurojnë kosto në zbutjen e rrezikut të efektshme;
- Një pjesë normale e ditës së veprimtarisë së përditshme, sistemet dhe procedurat e menaxhimit dhe proceset vendimmarrëse të të gjithë biznesit;
- Koordinuar të gjithë shoqërinë;
- Nënshtrohen vlerësimit të rregullt (p.sh. janë kontrollat efektive në zbutjen e rreziqeve kryesore);
- Nënshtrohet një procesi të sigurimit të përgjithshëm i cili gjithashtu adreson mjedisin më të gjerë të kontrollit.

Mjedisi i kontrollit përfshin qasjen e qeverisjes, stilin e menaxhimit, strukturën organizative dhe kulturën e gjerë brenda të cilit kontrollojnë aktivitetet që zhvillohen. Kontrollat shpesh janë kategorizuar në dy lloje:

- Pak përfshirëse - Kontrollat që zvogëlojnë gjasat e një ngjarje të rrezikut që ndodh. Planifikimi dhe strategjia e vendosjes, autorizimi dhe të dhënat hyrëse të kontrollit
 - Zbuluar - kontrollat që identifikojnë dukuritë e ngjarjeve të rrezikut, pasi ato kanë ndodhur dhe për të mundësuar veprime korigjuese që duhen ndërmarrë për të kufizuar shkallën e dëmtimit, p.sh. Alarme përjashtime dhe raportimi, si dhe shqyrtimet e rezultateve aktuale kundrejt pritjeve.
- Vlerësimi i rrezikut do të duhet të marrë në konsideratë efektivitetin me të cilin kontrollojnë rrezikun e zbutur. Një metodë është të marrin në konsideratë hartimin e një kontrolli dhe performancën e saj:
- Dizajni - konsideron si edhe kontrolli duhet të punojë në qoftë se është zbatuar gjithmonë në mënyrë se si ajo është menduar për të punuar;

- dhe
- Performanca - konsideron mënyrën në të cilën kontrolli është operuar në praktikë; në qoftë se është aplikuar kur duhet të jetë dhe në mënyrën e synuar nga projektuesi i saj.

Veprimtaritë e kontrollit kryhen në të gjithë Albsig dhe për të gjitha nivelet dhe funksionet, por në këtë Strategji kontrollat i referohen vetëm kontekstit të menaxhimit të riskut.

Veprimtaritë e kontrollit janë politika dhe procedura që ndihmojnë për realizimin e përgjigjes ndaj risqeve. Veprimtaritë e kontrollit kryhen në të gjithë Albsig, për të gjitha nivelet dhe funksionet, por në këtë Strategji kontrollat i referohen vetëm kontekstit të menaxhimit të riskut. Për qëllime të menaxhimit të riskut procedurat e kontrollit janë një element shumë i rëndësishëm për arritjen e objektivave. Ato nuk duhet të vendosen formalisht por konsiderohen si mekanizëm për të menaxhuar vetë arritjen e objektivave. Një skemë e thjeshtë e përgjigjes ndaj riskut shprehet në reagimin e matricës me poshtë:



PJESË E
KASTRATI GROUP




Tabela 8. Pergjigjja e matricës së riskut

Për shkak të shumëllojshmërisë të risqeve dhe reagimi ndaj tyre përfshin një numër të konsiderueshëm procedurash apo kontrollesh si përgjigje ndaj tyre, por Standardet përcaktojnë si më të zakonshmen **trajtimin e riskut nëpërmjet kontrolleve/procedurave të miratura nga shoqëria.**

Këto kontrolle kufizojnë mundësinë e një rezultati të padëshiruar. Kontrollat parandaluese përfshijnë ndarjen e detyrave, kufizimi i veprimeve të personave të autorizuar (psh, vetëm ata që janë trajnuar dhe autorizuar lejohen të kryejnë veprimtari të caktuara).

Synimi i tyre është parandalimi i ndodhjes së riskut përkatës dhe rritja e sigurisë së objektivat do të arrihen. Hartimi, miratimi dhe vënia në zbatim e Rregullores së brendshme të Albsig, Urdhrrat dhe Udhëzimet e Drejtorit të pergjiuthshem në harmoni me njesinë e perputhshmerise dhe standarteve.

4. Skenarët e stress-testeve

Stres-testet janë përgjithësisht përcaktuar duke iu referuar lëvizjeve në parametrat financiarë kryesorë (të tilla si normat e interesit, vlera e aktiveve ose vlerat e detyrimit), ndërsa testet e skenareve mund t'u referohen shkaqeve të zhvillimeve negative, të tilla si katastrofat materiale natyrore apo incidentet me të mëdha industriale.

Stres-testet duhet të jenë të përshtatura në profilin e tyre të rrezikut. Për këtë qëllim, duhet të identifikojnë rreziqet e mundshme afatshkurtra dhe afatgjata dhe ngjarjet e mundshme apo ndryshimet e ardhshme në kushtet ekonomike që mund të ketë një efekt të pafavorshëm në gjendjen e përgjithshme financiare për të përcaktuar ndikimin të kapitali.

Analizat e Skenareve duhet të bazohen në një sërë ngjarjesh, duke përfshirë ngjarjet ekstreme por të mundshme, dhe të marrë parasysh ndonjë efekt material të cilat mund të lindin.

Stres-testet janë ato që kërkojnë të vlerësojnë skenarët dhe rrethanat që do të bëjnë modelin e biznesit të paqëndrueshëm, duke identifikuar dobësitë e mundshme të biznesit. Testimi i stresit të kundert fillon nga një rezultat i modelit të biznesit dhe identifikon rrethanat në të cilat kjo mund të ndodh.

Gjatë 2016 shoqëria ka kryer prova të rezistencës nëse:

Rreziku i sigurimit: një tërmet, përmbytje në zonat ku shoqëria ka ekspozim të madh ndaj tyre;

Rreziku i kreditit: dështimi i një risiguruesi dhe/ose banke me ekspozim të lartë;

Rreziku operacional: përzgjedhja e metodës së provigjonimit të dëmeve dhe ndikimi i diferencave

me rezultatin e metodës së audituesit të pavarur, probleme me sistemin e shitjes së policave të sigurimit;

Rreziku i tregut: zhvlerësim i monedhës Lekë ndaj monedhave të huaja Euro, Dollarë;

Rreziku i likuiditetit: mosrinovim në masën 30% të kontratave në një nga portofolet kryesore si prona dhe MTPL.

5. Politika e pranimit dhe Administrimit të Rrezikut

Identifikimi dhe kategorizimi i rreziqeve

Në programin e administrimit të rrezikut identifikimi i rreziqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim e të gjitha rreziqeve të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria.

Shoqëria fokusohet tek rreziqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjike.

Këto rreziqe janë pjesë e procesit të administrimit të rrezikut për periudhën. Pjesë e procesit të administrimit të rrezikut janë dhe rreziqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme.

Kategoritë e rreziqeve

Rreziqet e pranishme në shoqëri janë të përfshira në një prej kategorive të identifikuara më poshtë:

Rreziku i Kreditit

Rreziku i kreditit i referohet rrezikut të mospagimit të detyrimeve kontraktuale të cilat rezultojnë në humbje financiare të shoqërisë. Në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kur pranohen primet fondet investohen për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj të siguruarve. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut nga fondet e mbajtura, depozitat dhe risiguruesit. Shoqëria ka vendosur procedurë të brendshme për risigurimet dhe rreziku është i monitoruar nga personat përgjegjës për risigurimet. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumenteve të borxhit dhe depozitave.

Informacione shpjeguese shtesë për primet e risigurimit të ceduara dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguruesit janë si më poshtë:

	2016				2015			
	Primet e ceduara		Aktivet e sigurimit		Primet e ceduara		Aktivet e risigurimit	
Norma	'000 Lek	% ndaj totalit	'000 Lek	% ndaj totalit	'000 Lek	% ndaj totalit	'000 Lek	% ndaj totalit
AA	963	0.90	327	0.85	1,568	1.85	105	0.30
A+	76,541	67.73	26,012	67.73	51,374	60.53	23,829	67.43
A	21,912	19.39	7,297	19.00	1,500	1.77	5	0.01
A-	11,660	10.32	4,113	10.71	21,217	25.00	11,341	32.09
AA-	1,934	1.71	657	1.71	6,709	7.91	50	0.14
BB	-	-	-	-	2,500	2.95	10	0.03
Pa normë	-	-	-	-	-	0.00	-	0.00
Totali	113,010	100.00	38,406	100.00	84,868	100.00	35,340	100.00

Tabela 9. Primet e risigurimit të ceduara dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguruesit

Rreziku i kreditit lidhet kryesisht me risigurimin, duke qenë se shoqëria, pavarësisht cedimit të rreziqeve tek risiguruesi ka detyrimin ndaj klientëve edhe nëse risiguruesit falimentojnë.

Shoqëria Albsig Sh.a. është pjesë e disa marrëveshjeve bashkësigurimi, ku pjesa e shoqërisë në të shumtën e rasteve është deri në nivelin 9.7%.

Rreziku i Tregut

Rreziku i tregut për shoqërinë lidhet kryesisht me faktorë të tregut financiar, si normat e interesit dhe kurset e këmbimit, apo faktorë të jashtëm, si ecuria ekonomike, si dhe humbje nga portofoli i investimeve.

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normave të interesit është i ndikuar nga rreziku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe rreziku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli rreziku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesi të tregut.

Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve interes mbartëse dhe rreziku i shkakimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënës. Në krahun tjetër, aktivet interes mbartëse kanë normë interesi fikse.

Rreziku i këmbimit të monedhës së huaj

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (LEKË, USD dhe EURO). Flukset monetare nga të ardhurat nga primet janë burimi kryesor i fondeve për depozitat me afat në valutë të huaj.

Rreziku i këmbimit të monedhës së huaj Lind nga lëvizjet në kurset e këmbimit të monedhës së huaj. Ekspozimi ndaj këtij rreziku kryesisht lind gjatë një periudhe në të cilën shoqëria ka një pozicion të hapur si në bilanc dhe jashtë bilancit dhe/ose me kursin aktual ose të ardhshëm të tregut. Është kryer analizë sasiore e rrezikut valutor të shoqërisë më 31 dhjetor 2016. Ndikimi i luhatjeve të kurseve të këmbimit është reflektuar për vitin e mbyllur 2016.

Rreziku Operacional

Rreziku operacional lind nga problemet në performancën e funksioneve ose proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku mund të lindë nga mangësitë ose defektet në kontrollet e brendshme ose proceset, defektet në teknologji, gabimet njerëzore ose pandershmeria dhe katastrofat natyrale.

Përdorimi më efikasitet i sistemit të shitjes, administrimit dhe dëmeve ka minimizuar shumë risqe duke bërë të mundur një harmonim më të mirë midis kontrollit dhe raportimit.

Rëndësi e madhe i është dhënë pagesës së dëmeve, duke e konsideruar një marketing për kompaninë. Pagesa e dëmit në një periudhë të shkurtër është një praktikë, e cila ndiqet deri në lajmërimin e klientit që vlera e dëmit të rënë dakord nga klienti ka kaluar në llogarinë e tyre dhe ka ndikuar në performancën e shoqërisë.

Analizat aktuariale ndikojnë në aplikimin e metodave më të mira aktuariale për llogaritjen e provigjoneve të dëmeve (IBNR) dhe për kontrolle më të forta mbi të dhënat nga Aktuari, sidomos të dëmeve shëndetësore të TPL, të cilat kanë luhatje në vlerësime. Për këtë Departamenti i Dëmeve bashkëpunon me Departamentin Juridik dhe Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe IT për marrjen e informacionit të plotë dhe në kohë për të gjitha rastet e ndodhura të dëmeve për tu ra-

portuar saktë për efekt të provigjoneve teknike të dëmeve si dhe azhurnimi i dëmeve në proces gjyqësor me vendimet e gjykatave në periudhat që raportohen dhe në zbatim të "Procedura për trajtimin e dëmëve sipas statuseve të tyre dhe rakordimi ndërmjet departamenteve përkatëse". Testimi i provigjimit të dëmeve është bërë nëpërmjet analizës RUN-OFF të dëmeve. Kjo analizë është bërë për dëmet e ndodhura dhe të raportuara (RBNS) në shoqëri dhe për dëmet e ndodhura dhe nuk janë të raportuara (IBNR). Teste për vlerësimin e provigjoneve të dëmeve në 31.12.2015 për sigurimin e detyrueshëm motorik TPL, Karton jeshil, Kufitare dhe Kasko janë bërë në mënyrë të vazhdueshme në periudhat në vazhdim duke marrë rezultate positive si rrjedhojë e rekomandimeve dhe rezultatve për provigjonet e dëmeve në 31.12.2014. Si më poshtë po japim një rezultat të përmirësuar për MTPL që zë dhe peshën kryesore në provigjonet e dëmeve total.

RUN-OFF 2015		MTPL
	Run-off Analyzis of RBNS (Lek)	
a	RBNS 2015	95,143,900
b	Claims paid 2016, reported before 2016	55,980,075
c	RBNS 2016 for claims reported before 2016	48,928,798
	Run-off result	(9,764,973)
	Run-off %	-10%
	Run-off Analyzis of IBNR (Lek)	
a	IBNR 2015	66,971,507
b	Claims reported in 2016 and paid in 2016, incurred before 2016	26,519,037
c	Claims reported in 2016 in RBNS 2016, incurred before 2016	16,000,986
	Run-off result	24,451,484
	Run-off %	37%
	Run-off Analyzis of IBNR (Lek)	
a	Claim reserve 2015	162,115,407
b	Claims paid 2016, reported before 2016	55,980,075
c	Claims reported in 2016 and paid in 2016, incurred before 2016	26,519,037
d	Claims reported in 2016 in RBNS 2016, incurred before 2016	16,000,986
e	Claims reserves 2016 remaining from 2008 excluding above cases a,b,c	48,928,798
	Run-off result	14,686,511
	Run-off %	9%

Tabela 10. Analiza RUN-OFF e dëmeve

Departamenti i Burimeve njerëzore të shoqërisë bën një punë efektive në përzgjedhjen profesionistëve në sigurime, agjentëve dhe ndërmjetësive me një cilësi sa më të mirë në shërbimin ndaj klientit duke iu referuar gjithmonë misionit kryesor të shoqërisë. Klienti në vizionin e shoqërisë sonë është i pari dhe shërbimi ndaj tij duhet të marrë një vlerë, e cila na bën konkurrenës në treg. Politikat e komunikimit dhe ato të motivimit të punonjësve luajnë një rol të rëndësishëm në mirëfunksionimin e burimeve njerëzore të shoqërisë Albsig sh.a.

Rreziku i Likuiditetit

Norma e likuiditetit është raporti midis aktiveve likuide të shoqërisë dhe detyrimeve të maturuara për pagesë si dhe detyrimeve që maturohen së shpejti.

Shoqëria e sigurimit konsiderohet likuide në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 6 të rregullores **"Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit"**, është më i lartë ose i barabartë me 1 (një).

Për qëllim të monitorimit të likuiditetit shoqëria bën monitorimin e fluksit të parasë në mënyrë periodike duke u bazuar në llogaritjet me bazë ditore të normës së likuiditetit.

Rreziku Ligjor dhe Rregullator

Rreziku ligjor dhe rregullator lidhet kryesisht me ndryshimin ligjor dhe rregullator.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut rregullator si krijimi i provigjoneve të primit të pafituar për sigurimin e detyrueshëm motorik sipas primeve të rrezikut të përcaktuar nga AMF, pavarësisht cmimeve të zbatuara nga shoqëria. Gjithashtu shoqëria duhet të ketë likuiditet për krijimin e rezervës monetare.

Rreziku Strategjik

Rreziku strategjik lidhet kryesisht me pozicionimin strategjik të shoqërisë në treg. Rreziqe strategjike për shoqërinë janë humbje e klientëve potencialë.

Rreziku i Sigurimit

Rreziku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosjes së Çmimit

Rreziku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësive

Shoqëria ka miratuar "Procedura dhe politika të brendshme lidhur me verifikimin e përputhshmërisë me politikën e marrjes në sigurim dhe sistemet e tarifimit të tyre".

Shoqëria ka miratuar urdhërin për nivelin e kompetencave të marrjes në sigurim të produkteve vullnetare për shumatat e sigurimit. Kufizimet janë të vendosura nga sistemi i shitjes dhe administrimit. Shoqëria ka miratuar udhëzimin për "Procedurat e policave të anuluar, dublikatave dhe zgjidhjes së kontratave.

Aktiviteti i marrjes në sigurim në shoqëri mbikqyret nga menaxher të nivelit të lartë, por aktiviteti i marrjes në sigurim është i ndarë në njësi të vecanta operative që mbikqyret nga menaxherët sipas linjave të vecanta të sigurimit. Tek marrja në sigurim në shoqëri përgjegjësitë e biznesit që përmbajnë rrisht të larta janë të mbikëqyrura nga menaxher me nivel të lartë profesional.

Sistemi i shitjes dhe administrimit ka menaxhim shumë të mirë të rrezikut të sigurimit duke vendosur procedura të forta të shitjes së policave të sigurimit.

Propozim të primeve dhe tarifave të produkteve nga sistemi duke mos lejuar shitjen nën këto prime pa marrë miratimin e personave përgjegjës.

Kufizime për shumatat e sigurimit tek policat vullnetare sipas kompetencave.

Kufizim në shitje të llojit të policave sipas userave të shitjes.

Parametizim të policës së sigurimit sipas kompetencave etj.

Shitja në kohë reale pothuajse e të gjithë produkteve.

Procedurë e fortë për anulimin, dublikatën dhe kthimin policave të sigurimit etj.

Në strukturën organizative të shoqërisë ka menaxhim më të mirë të njërive të marrjes në sigurim sipas linjave të sigurimit dhe përfshirja e njësisë së administrimit të policave. Njësia e administrimit të policave në cdo periudhë raportuese në bashkëpunim me njësitë e marrjes në sigurim sipas linjave të sigurimit kryejnë një kontroll rigoroz të policave fizike për të qenë në përputhje me kushtet e marrjes në sigurim. Kontratat e sigurimit fizike mbi 10% e Aftësisë Paguese kontrollohen edhe pranë Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut dhe IT. Në momentin e marrjes së informacioneve shtesë për policat e sigurimit shoqëria bën rishikim të kufijve të marrjes në sigurim. Gjithashtu nga personat përgjegjës kryhen kontrole ditore në kohë reale nëpërmjet sistemit të shitjes së policave, që policat e shitura të jenë në përputhje me kushtet e kontratave të sigurimit. Kur identifikohet që ka mangësi ose gabime në plotësimin e policës së sigurimit, këto raste raportohen në personat përkatës për t'u rregulluar.

Përsa i përket rrezikut të marrjes në sigurim sistemi i shitjes ka një rol të rëndësishëm dhe një kontroll në nivele ku çdo punonjës apo përdorues ka limitet e veta deri në finalizimin e marrjes në sigurim. Për produktin kasko, garanci ofertë, garanci kontratë etj me anë të sistemit të shitjes kontrollohen të gjithë agjentët të cilët kanë akses për të marrë në sigurim këto produkte dhe është përgjegjësi i këtyre produkteve që i monitoron dhe u miraton një vlerë më të madhe se e lejuara me anë të sistemit, tarifat preferenciale duke krijuar një historik të veprimeve deri në finalizimin përfundimtar të marrjes në sigurim.



6.Administrimi i kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese

Shoqëria ka objektiv kryesor që niveli i kapitalit që do mbajë do të jetë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Shoqëria do ruajë një nivel marzhi 250% ndaj kufirit minimal të kërkuar të kapitalit, sipas metodës me bazë primet ose dëmet, si dhe do synojë gradualisht dhe mbajtjen e një niveli të paktën 150% të fondit të garancisë.

Kjo strategji do të jetë ruajtja e kërkesave rregullatore në cdo kohë, përdorimi eficient i kapitalit, nëpërmjet analizës së vazhdueshme të treguesve të performancës. Duke patur parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi për nivelin e kapitalit është testuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet skenarëve të stresit, për të bërë të mundur zbutjen e rreziqeve që dobësojnë fuqinë e kapitalit. Shoqëria ka testuar, duke bërë provën e rezistencës mbi bazën e shumës së sigurura, pasi nuk ka të dhëna publike në lidhje me probabilitetet dhe dëmet e ndodhura nga katastrofat natyrore në vendin tonë. Në fund të vitit 2016 vlera e fondit të garancisë është Brenda të gjitha normave të kërkuara.

7. Rreziket, Rreziku i cmimeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, në vecanti TPL.

Në shoqërinë Albsig Sh.a produkti TPL është një produkt që zë peshë dhe përcaktimi i cmimit të këtij produkti ndikon në arritjen e objektivave strategjike të saj.

Shoqëria edhe për vitin 2016 ka bërë testime në rastin e uljes së primeve të TPL dhe përfundimi ishte që kishim fitim më të ulët për shoqërinë, që ndikon dhe në uljen e aftësisë paguese të shoqërisë.

Ky rrezik është i lartë për të gjithë tregun dhe në rast të destabilizimit të primeve të këtij produkti administrimi i këtij rreziku është i vështirë dhe do të kishim vonesa në pagesat e dëmeve dhe nënprovigjonim të dëmeve të këtij produkti. Në këtë mënyrë humbet besimin tek klientët, duke dëmtuar dhe linja të tjera të biznesit. Tregu i sigurimeve shqiptar është gjendur në një situatë të tillë, që do të thotë se probabiliteti i ndodhjes është i lartë.

Shoqëria duke e konsideruar element të rëndësishëm në administrimin e rrezikut është ulja e kohës midis raportimit, vlerësimit dhe pagesës së dëmit. Kjo praktikë mundëson provigjonim më të saktë të dëmeve, rrit saktësinë në tarifat dhe ul shpenzimet që vijnë si rrjedhojë e vonesave dhe proceseve gjyqësore. Gjithashtu shpejtësia në pagesa ndikon në marrëdhëniet me klientët duke arritur kështu një objektiv tjetër strategjik. Gjithsesi diversifikimi i portofolit është një tjetër strategji që shoqëria do të përdorë për zbutjen e këtij rreziku në afatmesëm.



5. RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

5.1 PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR

Bilanci Kontabël

më 31 dhjetor 2016 Shënime

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Aktivet			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12	37,168,812	29,516,529
Depozita me afat me bankat	6	1,007,910,330	881,067,772
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	8	109,603,479	88,528,659
Aktive të lidhura me risigurimin	7	38,405,623	35,340,346
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	11	72,840,098	48,724,150
Parapagim tatim mbi fitimin	28	17,458,056	-
Borxh i varur në filial		101,422,500	171,600,000
Aktive të tjera	10	54,145,129	35,282,487
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	24	261,355,633	190,915,377
Taks primi e shtyrë		-	18,395,257
Aktiv tatimor i shtyrë	28	-	3,257,426
Aktive afat-gjata materiale	4	368,016,140	232,778,891
Aktive afat-gjata jomateriale	5	6,051,894	5,001,670
Aksione në shoqëri të lidhura	13	437,018,400	367,993,400
Totali i aktiveve		2,511,396,094	2,108,401,964

Kapitali aksionar

Kapitali i nënshkruar	14	879,460,000	879,460,000
Fitimi i akumuluar		196,667,646	103,628,795
Totali i kapitalit aksionar		1,076,127,646	983,088,795

Detyrimet

Rezervat teknike për dëmet	15	354,794,627	296,592,934
Rezervat e primit të pafituar	16	859,178,999	640,757,050
Llogari të pagueshme për risigurimet	17	39,430,875	18,255,575
Detyrime ndaj palëve të lidhura	18	39,006,283	73,852,603
Tatim fitimi i pagueshëm		-	18,537,177
Detyrime të tjera	19	142,857,664	77,317,830
Totali i detyrimeve		1,435,268,448	1,125,313,169


Total i detyrimeve dhe kapitalit aksionar

2,511,396,094	2,108,401,964
----------------------	----------------------


Këto pasqyra financiare individuale për raportim specifik janë aprovuar nga Drejtimi i shoqërisë më

27 prill 2017 dhe janë firmosur nga:

Z. Muharrem Bardhoci
Drejtor i Përgjithshëm



Z. Irfan Lami
Drejtor i Financës



5.2 PASQYRA INDIVIDUALE E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Shpenzime të tjera të sigurimit	26	(237,744,009)	(97,677,965)
(Shpenzime)/ të ardhura financiare, neto	27	(8,345,622)	(3,294,259)
Totali i shpenzimeve operative		(976,636,784)	(651,818,689)
Fitimi i vitit para tatimit		118,250,531	136,924,988
Tatim fitimi	28	(25,211,680)	(33,296,193)
Fitimi i vitit pas tatimit		93,038,851	103,628,795
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		93,038,851	103,628,795

5.3 PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

	Kapitali	Rezerva e	Rezerva te	Fitime /	Totale
	Aksionar	katastrofës	tjera kapitali	(humbje)	
				e mbartur	
Gjendja më 1 janar 2015	879,460,000	5,100,000	42,036,000	71,694,027	998,290,026
Dividendi i deklaruar	-	-	-	(118,830,027)	(118,830,027)
Fitimi i vitit	-	-	-	103,628,795	103,628,795
Rimarrja e rezervës së kapitalit rregullator në filial	-	-	(42,036,000)	42,036,000	-
Rimarrja e rezervës së katastrofës	-	(5,100,000)	-	5,100,000	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	(5,100,000)	(42,036,000)	31,934,767	(15,201,233)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	879,460,000	-	-	103,628,795	983,088,793
Fitimi i vitit	-	-	-	93,038,851	93,038,851
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	93,038,851	93,038,851
Gjendja më 31 dhjetor 2016	879,460,000	-	-	196,667,646	1,076,127,646

5.4 PASQYRA INDIVIDUALE E FLUKSEVE MONETARE

më 31 dhjetor 2016

Shënime	Viti i mbyllur më	Viti i mbyllur më
	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga veprimtaritë operative		
Fitimi neto para tatimit	118,250,531	136,924,988
<i>Rregullime për zërat jo-monetare në fitim ose humbje:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4.5	25,079,129
Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve materiale e jo-materiale		641,398
Zhvlerësim i te arkëtushmeve	9	13,844,682
Të ardhurat nga interesi	23	(12,980,925)
Shpenzime interesi		2,858,783
Flukset e parasë nga veprimtaritë operative para ndrvshimeve në aktivet dhe detvrimet operative	147,693,597	165,965,348
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative:</i>		
Rritja në llogaritë e arkëtueshme bruto nga Rritje në aktive të lidhura me risigurimin		(40,406,342)
Rritje në kosto të shtyra të marrjes në sigurim		(3,065,277)
Pakësim i taksës së primit të shtyrë		(70,440,255)
Rritje në aktive të tjera		(18,395,257)
Rritje në llogari të pagueshme për sigurimet,		(42,978,590)
Rritje në detyrime të tjera		21,175,300
Rritje në rezervat e primit të pafituar		10,138,482
Rritje në rezervat teknike për dëmet		12,156,336
		(40,761,245)
		218,421,949
		195,141,327
		58,201,693
		63,814,998
Flukset neto të parasë përdorur në veprimtaritë operative	319,153,669	237,935,976
Flukset e parasë gjeneruar nga veprimtaria operative		
Tatimi fitimi i paguar	28	(39,412,310)
Interesi i paguar		(18,016,441)
Interesi i arkëtuar		(2,858,783)
		(2,504,390)
		8,345,622
		12,708,612
Flukset e parasë neto gjeneruar nga veprimtaritë operative	285,228,198	230,123,757
Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerje të aktiveve afat-gjata materiale	4	(159,869,144)
Blerje të aktiveve afat-gjata jo materiale	5	(2,138,856)
Rritja e borxhit të varuar dhe investimeve në filial		1,152,500
Rritje e depozita me afat me bankat		(122,207,255)
		19,572,697
Flukset e parasë neto përdorur në veprimtaritë investuese	(283,062,755)	(135,443,527)
Flukset e parasë nga veprimtaritë e financimit		
Dividendët paguar ndaj aksionarëve		-
		(83,382,385)
Flukset e parasë neto përdorur në veprimtaritë e financimit	-	(83,382,385)
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë bankë	2,165,443	11,297,845
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit		29,516,529
Efekte kursi negative		5,486,840
		789,874
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	37,168,812	29,516,529

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR**Aksionarëve ALB - SIGURACION sh.a.*****Opinion***

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të "ALB - SIGURACION sh.a." (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e veçantë të bilancit kontabël më datë 31 dhjetor 2016, pasqyrën e veçantë të të ardhurave dhe shpenzimeve gjithpërfshirëse, pasqyrën e veçantë të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e veçantë të flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit të veçantë financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016, të rezultatit të saj të veçantë financiar dhe të fluksit të veçantë të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të veçanta në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të veçanta.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- * Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- * Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionin mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- * Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Shoqëria.
- * Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare të veçanta, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- * Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të veçanta, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të veçanta paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e "ALB - SIGURACION sh.a.", përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raportet për agjensitë rregullatore – kërkesa e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë për marzhin e Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave Teknike

Në vijim të kërkesave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, ne kemi lexuar Skedulet Suplementare bashkëlidhur për "Aktivet në mbulimin të rezervës teknike," dhe "Marzhin e aftësisë paguese" ("Skedulet Suplementare"). Skedulet Suplementare të përgatitura nga drejtimi, nuk janë pjesë e pasqyrave financiare të veçanta bashkëlidhur. Informacioni financiar historik, i paraqitur në Skedulet Suplementare të përgatitura nga drejtimi, është i qëndrueshëm, në të gjitha aspektet materiale me informacionin financiar vjetor, pasqyruar në pasqyrat financiare të veçanta të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016, përgatitur në përputhje me legjislacionin kombëtar të kontabilitetit, të aplikueshëm për shoqëritë e sigurimit në Shqipëri. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e Skeduleve Suplementare, në përputhje me Ligjin nr. 52, "Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit," të datës 22 maj 2014.

Ernst & Young Ekspert Kontabël i Autorizuar
Dega Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors

28 Prill 2017

Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Mario Vangjel

6. AKTIVITETI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2016

Objektivi dhe Qëllimi

Auditimi është një aktivitet i pavarur dhe objektiv konsulence për të dhënë siguri dhe udhëhiqet nga parimi për të shtuar vlerë në përmirësimin e operacioneve të Alb Siguracion Sh.A. (Shoqëria). Auditimi e ndihmon Shoqërinë në arritjen e objektivave të saj, duke nxitur një sjellje sistematike dhe të disiplinuar në vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të qeverisjes së brendshme, manaxhimit të riskut dhe kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.

Baza Ligjore

Aktiviteti i auditimit të brendshëm është kryer në mënyrë të atillë për të përmbushur më së miri:

- Kërkesat e Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe kërkesat e rregullores "Për Veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit" miratuar me vendimin e Bordit nr. 153, datë 23.12.2014;

- Praktikat me të mira ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm të rekomanduara nga Instituti Ndërkombëtar i Auditimit të Brendshëm.

Auditimi i brendshëm është një funksion i cili vetërregullohet duke ndjekur Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Profesionit të Auditimit të Brendshëm dhe Kodin e Etikës së Shoqërisë. Këto parime përbëjnë principet e funksionimit dhe praktikës profesionale të auditimit të brendshëm dhe shërbejnë për të vlerësuar efektivitetin e aktivitetit dhe performancës së auditimit të brendshëm.

1. VETËRREGULLIMI I FUNKSIONIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Struktura Organizative dhe Raportimi

Auditimi i Brendshëm është një strukturë e miratuar me shumicë të cilësuar nga Këshilli Mbikqyrës. Auditimi i Brendshëm sipas organizimit të ri të Shoqërisë raporton tek Komiteti i Auditimit dhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë tek Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë.

Vetë funksioni i auditimit të brendshëm është i organizuar në nivelet si më poshtë:

- * Drejtor i Auditimit të Brendshëm
- * Asistent / Senior Auditor i Brendshëm

Për kualifikimin e vazhdueshëm në fushën e Auditimit të brendshëm, personeli i departamentit është angazhuar dhe ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme trajnimi, çertifikimi dhe programe profesionale në fushën e auditimit të brendshëm. Konkretisht, kualifikime të marra nga ISSAT "Instituti i Studimeve Strategjike dhe Trajnimeve" dhe nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm në Shqipëri, si dhe kualifikim i vazhdueshëm për çertifikimin e Association of Chartered Certified Accountants (ACCA).

Karta e Aktivitetit të Auditimit të Brendshëm (Internal Audit Activity Charter)

Auditimi i brendshëm ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Kartën e Auditimit të Brendshëm, e cila përshkruan misionin, qëllimin, objektivat e punës dhe përgjegjësinë e funksionit të auditimit të brendshëm të Shoqërisë.

Manuali i Auditimit të Brendshëm

Sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (SNAB), auditimi i brendshëm ka një definicion të mirëpërcaktuar dhe konsiderohet si një aktivitet konsulence dhe e dhënies së një sigurie të pavarur e objektive dhe udhëhiqet nga parimi për të shtuar vlerë në përmirësimin e operacioneve të Shoqërisë. Auditimi i brendshëm e ndihmon Shoqërinë në arritjen e objektivave të saj, duke nxitur një sjellje sistematike dhe të disiplinuar në vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të qeverisjes së brendshme, manaxhimit të riskut dhe kontrolleve të brendshme të Shoqërisë. Për të rregulluar mënyrën e funksionimit, procedurat, dokumentimin, raportimin etj, Auditimi i Brendshëm ushtron aktivitetin në përputhje me Manualin Operacional të Aktivitetit të Auditimit të Brendshëm. Manuali është një dokument gjithëpërfshirës i cili përmbledh dhe rregullon aspektet kryesore të aktivitetit të auditimit të brendshëm. Manuali është përpiluar në mënyrë që të përmbushë kërkesat e praktikave më të mira ndërkombëtare, SNAB si dhe kërkesat ligjore dhe rregulative të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF) në Shqipëri. Manuali Operacional i Aktivitetit të Auditimit të Brendshëm është miratuar me vendim të Komitetit të Auditimit të Brendshëm me proces verbal Nr. 02, datë 29/04/2016.

Programi i Auditimit për Vitin 2016

Plani vjetor i Auditimit të Brendshëm për vitin 2016 u miratua me vendim Nr. 3 të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, në datë 29.02.2016.

Plani i auditimit të brendshëm ka një fokus drejt riskut dhe mbulon aspekte kritike të veprimtarisë së Shoqërisë. Në plan janë përcaktuar afatet e përmbushjes së aktiviteteve të parashikuara të cilat janë realizuar në kohë dhe më së miri.

Rezultatet e Aktivitetit të Auditimit për 2016

Referuar planit të auditimit të brendshëm për vitin 2016 miratuar nga Këshilli Mbikqyrës me vendimin Nr. 03 te datës 29.02.2016, janë realizuar aktivitetet e auditimit si më poshtë:

Administrimi dhe manaxhimi i rrezikut të shoqërisë.

Krahas organizimit të brendshëm dhe rregullimit të departamentit të manaxhimit të riskut dhe IT, objektivat e kontrollit ku u fokusua angazhimi i auditimit ishin (i) rishikimi i politikave të shkruara, manualeve dhe rregulloreve të brendshme; (ii) rishikimi i roleve dhe përshkrimeve të punës; (iii) tools-et, raportimet dhe aktivitetet e manaxhimit dhe administrimit të rrezikut.

Si rezultat i procedurave të kryera, nuk janë evidentuar problematika ose gjetje madhore me impakt të lartë për shoqërinë. Auditimi i brendshëm ka dhënë rekomandimet e tij për dokumentimin e proceseve dhe raportimet për manaxhimin e riskut.

Organizimi i departamentit dhe dokumentacioni i dosjeve të dëmeve.

Krahas organizimit të brendshëm dhe rregullimit të departamentit të dëmeve, objektivat e kontrollit ku u fokusua angazhimi i auditimit ishin (i) administrimi i dosjeve të dëmeve; (ii) rishikimi i arritjes së përputhshmërisë me kërkesat dhe rregulloret e AMF për raportimin dhe dokumentacionin dhe (iii) pranimi dhe procesimi i dëmeve në përgjithësi.

Si rezultat i procedurave të kryera, nuk janë evidentuar problematika ose gjetje madhore me impakt të lartë për shoqërinë. Auditimi i brendshëm ka dhënë rekomandimet e tij në lidhje me angazhimin e kryer.

Përputhshmëria me rregulloret në lidhje me indikatorët për: (i) Aktivet në mbulim të rezervës teknike dhe (ii) Marzhin e aftësisë paguese.

Objektivi i angazhimit për rishikimin e përputhshmërisë në lidhje me mbajtjen dhe raportimin e paramentrave (indikatorëve) për Aktivet në Mbulim të Rezervës Teknike dhe Marzhit të Aftësisë Paguese ka qenë rishikimi i procedurës së nxjerrjes, rakordimit dhe raportimit të të dhënave financiare dhe më pas përlllogaritja dhe raportimi tek AMF.

Në lidhje me këtë angazhim, manaxhimit të shoqërisë i janë bërë prezent rekomandimet përkatëse.

Raportimi financiar dhe kontabiliteti

Krahas organizimit të brendshëm dhe rregullimit të departamentit të financës, objektivat e kontrollit ku u fokusua angazhimi i auditimit ishin (i) rishikimi i politikave të shkruara, manualeve dhe rregulloreve të brendshme; (ii) rishikimi i roleve dhe përskrimeve të punës; (iii) tools-et, raportimet Si rezultat i procedurave të kryera, nuk janë evidentuar problematika ose gjetje madhore me impakt të lartë për shoqërinë. Auditimi i brendshëm ka dhënë rekomandimet e tij në lidhje me angazhimin e kryer.

Debitoret dhe llogaritë e arkëtueshme (Ekspozimi)

Objektivat e kontrollit ku u fokusua angazhimi i auditimit ishin (i) rishikimi i politikave të shkruara për limitet e debitimit të klienteve, rregulloreve dhe udhëzimeve të brendshme për rakordimin dhe ndjekjen e llogarive të arkëtueshme në vonesë; (ii) rishikimi i roleve dhe përskrimeve të punës të financës dhe agjentëve në lidhje me manaxhimin e debitorëve; (iii) tools-et, raportimet e brendshme financiare dhe aktivitetet e rakordimeve mes agjentëve, degëve me departamentin me financës.

Si rezultat i procedurave të kryera, nuk janë evidentuar problematika ose gjetje madhore me impakt të lartë për shoqërinë. Auditimi i brendshëm ka dhënë rekomandimet e tij në lidhje me angazhimin e kryer.

Manaxhimi i aktiveve afatgjata materiale të shoqërisë

Objektivat e kontrollit ku u fokusua angazhimi i auditimit ishin (i) rishikimi i procesit të manaxhimit dhe administrimit të aktiveve afatgjata materiale, (ii) rishikimi i politikave të shkruara, manualeve dhe rregulloreve të brendshme për manaxhimin e aktiveve afatgjata materiale; (iii) rishikimi i roleve, përgjegjësisive dhe përskrimeve të punës; (iii) tools-et dhe modulet e përdorura për ditaret e aktiveve afatgjata materiale.

Si rezultat i procedurave të kryera, nuk janë evidentuar problematika ose gjetje madhore me impakt të lartë për shoqërinë. Auditimi i brendshëm ka dhënë rekomandimet e tij në lidhje me angazhimin e kryer.

RAPORTI I AUDITORIT TË BRENDSHËM

Drejtuar: Komitetit të Auditimit dhe Këshillit Mbikqyrës të Alb Siguracion Sh.a

Auditimi i Brendshëm ka kryer angazhimet e tij për vitin 2016 fokusuar në çështjet e klasifikuara me prioritet të lartë dhe me prioritet të mesëm sipas Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2016, aprovuar nga Këshilli Mbikqyrës, me vendim Nr. 03, datë 29.02.2016.

Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me Kartën e Auditimit të Brendshëm, kerkesat e rregullores "Për Veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit" miratuar me vendimin e Bordit nr. 153, datë 23.12.2014 dhe praktikat me të mira ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm të rekomanduara nga Instituti Ndërkombëtar i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i brendshëm ka bazuar planifikim e tij për angazhimet që ka ndërmarrë mbi bazën e risqeve me të cilat përballlet shoqëria, duke përzgjedhur veprimtaritë me kyçe, me impakt të lartë dhe me ekspozim të konsiderueshëm ndaj tyre.

Auditimi i brendshëm nuk ka pasur konflikte interesi dhe ka qenë i pavarur dhe i pandikuar nga ndërhyrje për mënyrën e organizimit si dhe nga çdo ndërhyrje në lidhje me përcaktimin e qëllimit, procedurave, shpeshëtisë së kontrollit, apo përmbajtjen e raportit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Brendshëm

Si rezultat i kryerjes së aktiviteteve të auditimit të brendshëm, për vitin 2016, përveç çfarë është raportuar vazhdimisht për tematika të veçanta, **nuk janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale të cilat të kenë një impakt domethënës në aktivitetin e Shoqërisë**. Janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procedurave, administrimin e informacionit dhe dokumentave si dhe proceseve të ndryshme fokusuar në risk si dhe është monitoruar niveli i realizimit të tyre.

Në mbyllje të procedurave të auditimit për vitin 2016 **është vërejtur një nivel i kënaqshëm i kontrolleve të brendshme (qeverisja e Shoqërisë)**.

Auditimi i Brendshëm



7. OBJEKTIVAT E SHOQËRISË PËR VITIN 2017

Në kuadrin e realizimit të objektivit të vitit 2017, për strukturat organike të shoqërisë mbeten parësore drejtimit e mëposhtme:

Rritja e prezencës në tregun e sigurimeve nëpërmjet shfrytëzimit më mirë të oportuniteteve që ofron tregu, me synimin e asimilimit të 15% të potencialeve të tij.

Struktura organizative për marrjen në sigurim sipas linjave të sigurimit do të jetë agresive në treg. Ngritja e nivelit profesional të specialistëve të marrjes në sigurim nëpërmjet trajnimeve. Trajnimi për linjat kryesore dhe të reja të biznesit, duke i dhënë prioritet paketave të sigurimit vullnetar dhe kërkesës së tregut. Tregu i sigurimeve do vit gjeneron produkte të reja për të qenë sa më afër klientit dhe për të dhënë një mbrojtje klientit dhe bizneseve.

Veprim intensiv në linjat e sigurimit vullnetar me objektiv primar konkretizimi me 46 % të primeve të planifikuara nga portofoli i sigurimeve vullnetare, pra fluksi i të hyrave të predominohet nga linjat vullnetare të sigurimit.

Rritja dhe kompletimi i rezervës teknike me burime të mjaftueshme financiare, diktuar nga:

Zgjerimi i gamës së produkteve;

Impulset pozitive të rritjes në tërësi të të ardhurave nga linjat e sigurimit.

Minimizimi i shpenzimeve dhe suprimimi i strukturave jo produktive. Përmirësimi i mëtejshëm i raportit të shpenzimeve administrative me primet, me tendencë plotësimin e standarteve dhe parametrave rajonalë.


Perfeksionimi i linjave të biznesit, të administrimit tekniko-ekonomik dhe financiar, nëpërmjet implementimit të skemave sa më optimale të shërbimit informatik, etj.

Arritjet dhe përvoja e deritanishme, objektivat e synuara, avantazhet dhe dizavantazhet që prezanton tregu, shërbejnë si bazë dhe në tërësi reflektohen në programin ekonomik-financiar të vitit 2017. Programi që paraqitet është ambicioz që garanton efektivitetin e shpenzimeve, sikundër edhe zhvillimin e mëtejshëm, konform standarteve ligjore dhe rritjen e potencialeve financiare të shoqërisë.

Eshtë parashikuar një rritje me rreth 181,000 mijë lekë në rezervat teknike, kundrejt nivelit të tyre në fundvitin 2016, si domosdoshmëri aktuaristike e mbështetjes së rritjes së aktivitetit përgjatë vitit 2017, si dhe për mbulimin e efekteve të rritjes së dëmeve shëndetësore.

Pavarësisht se të ardhurat janë planifikuar me një rritje prej rreth 10 % kundrejt vitit 2016, shpenzimet totale për vitin 2017 janë planifikuar që me këtë nivel shpenzimesh të realizohet më shumë të ardhura.

Shoqëria për vitin 2017 ka miratuar dhe programin e risigurimit 2017 ku ndryshim thelbësor ka limiti i kontratës së pronës, e cila për rrisht është 10 milion euro dhe për ngjarje është 15 milion euro ku janë shtuar dhe Përgjegjësitë dhe Aksidentet.







PJESË E
KASTRATI GROUP

Adresa

ALBSIG sh.a
Rruga "George W. Bush", Nr. 10,
Tirana, Albania



Telefon & Fax

Tel: +355 422 54 764
Cel: +355 68 20 52 744



Online

Email: info@albsig.al
Website: www.albsig.al
